

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of
Justice*

UZURPIMI I PALIGJSHËM DHE RIKTHIMI I PRONAVE

Arian Gashi & Besim Kelmendi
Prokuror të Shtetit

Prishtinë

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës

© ADK 2021, Të gjitha të drejtat e rezervuara

Përmbajtja e këtij moduli nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë (AD).

Pikëpamjet e autorit nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë së Kosovës.

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Tabela e përmbajtjes së modulit

HYRJJE

Hyrje.....	4
Objektivat mësimore.....	4
Metodat e të mësuarit	5
Pritjet nga pjesëmarrësit	5
Burimet dhe literatura.....	5
Ushtrime	6
Përmbledhja.....	6

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave - PREZANTIMI

1. Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave	7
2. Vepra penale e uzurpimit të paligjshëm sipas KPRK-ës	7
3. Kushtet ligjore që kërkohen të përmbushen për ekzistimin e kësaj vepre penale.....	8
4. Sanksionet penale që mund të shqiptohen kryesve të kësaj vepre penale si dhe Dënimet plotësuese.....	10
5. Praktika gjyqësore lidhur me politikën ndëshkimore të gjykatave në Republikën e Kosovës:.....	11
6. Të gjeturat e përgjithshme lidhur me Uzurpimin e paligjshëm dhe rikthimin e pronave.....	11
7. Ri/Kthimi i pronave të uzurpuara pronareve.....	12
8. Trajtimi i Uzurpimit të paligjshëm me Ligjin mbi procedurën Kontestimore.....	13
9. Dallimi midis procedurës civile dhe penale të Uzurpimit të paligjshëm të Pronës.....	15
10 Trajtimi i uzurpimit të paligjshëm sipas ligjit nr.05/L - 010 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës.....	15
11. Udhëzimi administrativ (QRK) nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për shkatërrimin e strukturave të paligjshme.....	15
12. AKTVENDIM PER PAPRANUESHMERI – Gjykata Kushtetuese e Kosovës ne rastin nr. K1180/19.....	16
13. Raporti vjetor nr.15 i vitit 2015 i Institucionit të Avokatit të popullit.....	23
14. Raporti i OSBE-s – Janar 2015: Shqyrtimi rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm në Kosovë.....	26
15. Konkluzione të përgjithshme të trajnimit- Rekomandime.....	37

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Hyrje

Uzurpimi i paligjshëm i pronës sipas legjislacionit penal në fuqi në vendin tonë është vepër penale e cila hyn në kapitullin e XXVI tek veprat penale kundër pasurisë e sanksionuar me nenin 320 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të aplikueshëm.

Në vendin tonë kjo çështje po ashtu gëzon mbrojtje juridike edhe me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore nga se pronari për çfarëdo shqetësimi në shfrytëzimin e pronës së tij ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore me padi pranë gjykatës kompetente.

Për shkak të rritjes së numrit të madh të uzurpimeve të pronave të huaja është paraqitur edhe nevoja që pronarëve të këtyre pronave të paluajtshme të ju ofrohet edhe mbrojtje nëpërmjet së drejtës penale me qëllim që të parandalohet keqpërdorimi i këtyre me prona të huaja.

Përmes këtij trajnimi synohet që të definohen kushtet ligjore që duhet të përmbushen për tu konsideruar ekzistimi i kësaj vepre penale, si dhe përmes procedurave penale jo vetëm që kryesi shpallet fajtor, por edhe realizohet kthimi i pronës tek pronari si dhe kompensimi i dëmit të shkaktuar nga kjo vepër penale.

Po ashtu në kuadër të këtij moduli do të trajtohet edhe çështja e kthimit të pronës si kërkesë e palëve në procedurë, që po ashtu është temë e një rëndësie të veçantë ngase parimisht në një çështje penalo-juridike, shpeshherë ndodh të zbatohen edhe dispozitat e procedurës civile, gjë që në këtë rast gjykata është e obliguar ta bëjë këtë në procedurë penale për vendosje të kërkesës për kthimin e pronës për çka është e rëndësishme që të flasim edhe për sfidat e procedurës në rastet kur kemi propozime të palëve për kthimin e pronës. Përkitazi me këtë do të trajtohet mënyra e vendosjes së kërkesave për kthimin e pronës e për të cilat palët paraqesin kërkesat e tyre në procedurë penale.

Objektivat trajnuese

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në përfundimin e tij duhet ti arrijnë këto objektiva:

- Të kuptojnë nocionin e uzurpimit të paligjshëm dhe rikthimi i pronave;
- Të mësojnë çka përfshihet në kuadër të uzurpimit të paligjshëm dhe rikthimit të pronave ;
- Të zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me këtë vepër penale;
- Të avancojnë njohuritë rreth kushteve ligjore që duhet të përmbushen për ekzistimin e kësaj vepre penale;
- Të identifikojnë dallimet se në cilat raste kemi të bëjmë me raporte civilo-juridike, e jo me vepër penale;
- Kush mund të paraqesë propozim për kthimin e pronës dhe deri kur mund të paraqitet kërkesa në fjalë;
- Mënyra e vendosjes për propozimit për kthimin e pronës.

Metodat e të mësuarit

Metodologjia që do të përdoret në këtë trajnim është e kombinuar duke filluar një prezantim të shkurtër të objektivave mësimore dhe më pastaj për të vazhduar me metodën prezantimit të temës nga ana e trajnuesit, duke trajtuar secilën temë veç e veç e përcjellë me rastin studimor

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

e që kjo do të jetë shkak për vazhdimin e trajnimit me metodë interaktive që do të jetë e përshtatshme që ti nxisë pjesëmarrësit të zhvillojnë debat dhe të paraqesin sfidat që kane hasur me rastin e aplikimit të dispozitave të kësaj pjese.

Kurse pjesa përfundimtare e trajnimit do të jetë e rezervuar që pjesëmarrësit përmes pyetjeve dhe debatit do të paraqesin pikëpamjet nga këndvështrimi i tyre rreth temës së shtjelluar dhe implementimit në praktikë të njohurive të përfituara nga ky trajnim dhe si rrjedhojë e këtij debati në përfundim të trajnimit do të mund të paraqesin ndonjë konkluzion.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritet që të jenë aktivë gjatë gjithë trajnimit, duke dhënë kontributin e tyre në diskutime, në mënyrë që me pjesëmarrjen e tyre të ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të këtij programi.

Gjithashtu nga pjesëmarrësit pritet që të parashtrojnë pyetje, të ofrojnë zgjidhje, sqarime dhe sugjerime gjatë gjithë kohës sa zgjat trajnimi.

Ata do të angazhohen në mënyrë aktive përmes diskutimeve, debateve, punës në grupe si dhe do të merren me raste për studim etj.

Burimet dhe literatura

Pjesëmarrësit e programit mund të shfrytëzojnë si burime për të mësuar përveç materialit të prezantuar edhe nga:

- Kodi i procedurës Penale i Republikës së Kosovës – 2013
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës – 2013
- E drejta Penale, Dr. Ismet Salihu, Prishtinë 2012
- Komentari i Kodit Penal dhe të Procedurës Penale, Ismet Salihu, Hilmi Zhitia dhe Fejzullah Hasani, Fejzullah (2014).
- Ligji mbi procedurën Kontestimore i aplikueshëm në Kosovë.
- Ligji Nr. 05/L -010 Për agjencinë kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës.
- Udhëzimi administrativ (QRK) nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për shkatërrimin e strukturave të paligjshme.
- Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në rastin nr. K1180/19.
- Raporti vjetor nr.15 i vitit 2015 i Institucionit të Avokatit të popullit.
- Raporti i OSBE-s – Janar 2015 për: Shqyrtimi rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm në Kosovë.
- Raste nga praktika të aktakuzave dhe vendimeve gjyqësore të gjykatave lidhur me temën

Ushtrime

Gjate shqyrtimit të temave në fjalë – pra për uzurpimin e paligjshëm dhe rikthimi i pronave do të prezantohen disa shembuj praktik të cilët do të ju shpërndahen pjesëmarrësve ashtu që më parë planifikohet të bëhet ndarja në grupe dhe atë varësisht nga numri i pjesëmarrësve, ku pastaj pas punës do të prezantojnë të gjeturat përkitazi me temën dhe diskutimet do të përqendrohen në mënyrën e vendosjes për uzurpim të paligjshëm dhe kthim të pronave varësisht nga llojet e aktgjykimeve.

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Përmbledhje

Në këtë modul diskutimi qendror bëhet rreth qëllimit të modulit, objektivave trajnuese, metodave të shpenguarit, pritjet nga pjesëmarrësit si dhe për burimet nga të cilat mund të mësohet për uzurpimin e paligjshëm dhe rikthimi i pronave .

Gjithashtu gjatë këtij moduli do të merren parasysh sugjerimet nga pjesëmarrësit lidhur me metodat e të shpjeguarit dhe shtjellimet të moduleve në përgjithësi.

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Prezantimi i temës:

1. Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

E Drejta në pronë në Republikën e Kosovës sikurse edhe në shumicën e vendeve me demokraci të zhvilluar është e Drejtë Kushtetuese pasi që mbrohet me nenin 46 par. 1 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku theksohet se:” Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona”. E drejta në pronë përveç që është e drejtë Kushtetuese kjo e drejtë është e sanksionuar si vepër penale e veçantë edhe me dispozitat e Kodit penal të aplikueshëm në Kosovës respektivisht nenin 320 të këtij kodi si “Uzurpim i paligjshëm i pronës”. Kjo e drejtë sigurohet edhe në procedurë civile përmes të drejtës për të ushtruar “padi për pengim posedimi” apo me padi tjera të cilat sigurojnë kthimin e tokës pronarit të ligjshëm të pronës, ngase pronari, në rast të çfarëdo shqetësimi në shfrytëzimin e pronës së tij, ka të drejtë që, në përputhje me këto dispozita, të kërkojë mbrojtje ligjore me padi për pengim posedimi apo padi tjera. Për shkak të rrethanave të krijuara pas luftës dhe pushtimeve masive të pronave të huaja të braktisura, është paraqitur nevojë imediate që pronarëve të pronave të këtilla të paluajtshme t’u ofrohet mbrojtje edhe nëpërmjet së drejtës penale, e më pastaj edhe në procedurë administrative me qëllim që abuzimi i këtillë me prona të huaja të parandalohet.

E drejta në pronë qytetarëve të Republikës së Kosovës u garantohet apo sigurohet edhe në procedurë administrative sipas ligjit nr 05/L-010 për agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikimit të pronës e cila rregullon procedurën e dëbimit nga prona e uzurpuar e cila procedurë është e ndërlidhur me nenin 320 par. 3 të KPRK-ës e cila paraqet rrethanë rënduese nëse kryesi është dëbuar edhe më parë prej pronës që e ka uzurpuar me vendim të gjykatës apo me urdhër apo vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm në Kosovë.

Pra si përfundim e Drejta në Pronë është e drejtë e garantuar, mbrojtur dhe rregulluar përmes tri procedurave : penale, civile dhe administrative për të cilat do të flasim në mënyrë të detajuar gjatë këtij trajnimit.

2. Vepra penale e uzurpimit të paligjshëm sipas KPRK-ës

Uzurpimi i paligjshëm i pronës hyn në kapitullin e 26 të KPRK-ës tek veprat penale kundër pasurisë, me të cilën mbrohet pasuria e huaj e paluajtshme, (pasuria e një personi tjetër), nga pushtimi i kundërligjshëm, përkatësisht nga çdo veprim i pambështetur në ligj, me të cilin veprim pronari ligjor pengohet ose pamundësohet në shfrytëzimin e qetë të pasurisë së tij. Menjëherë pas lufte në Kosovë pas vendosjes së administratës së UNMIK-ut kjo vepër penale parashihej si vepër penale “**Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme**” e sanksionuar sipas nenit 259 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës dhe atë ishte e rregulluar në dy paragraf:

(1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

(2) Nëse prona e paluajтshme e pushtuar është pjesë e pyllit të mbrojtur, parkut të mbrojtur apo pyllit tjetër me destinim të posaçëm apo është tokë ndërtimore, kryerësi dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Ndërsa me vonë me Kodin Penal Pasues që ka hyrë në fuqi në janar 2013 kjo vepër penale parashihej me nenin 332 i KPRK-ës por tani me emërtim të ri ku në vend të fjalës Pushtim kemi fjalën Uzурpim dhe atë “ Uzурpimi i paligjshëm i pronës së paluajтshme”. Këtë emërtim kjo vepër penale e ka edhe tani në Kodin e aplikueshëm penal në fuqi nga Prilli 2019 vetëm se ka ndryshuar nenin tani është e sanksionuar në nenin 320 kurse përmbajtja ka mbetur e njëjtë sikurse edhe dënueshmëria.

Tani me kodin e ri aktual kjo vepër penale është e rregulluar në 3 paragrafe:

1. Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajтshme të personit tjetër apo një pjesë të saj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në një apo më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet:

2.1. nëse prona e paluajтshme e uzurpuar është pjesë e pyllit të mbrojtur, parkut të mbrojtur apo pyllit tjetër me destinim të posaçëm, tokës ndërtimore ose rrugës;

2.2. nëse kryesi ka uzurpuar pronën e paluajтshme duke e ditur se pronë e tillë i është nënshtruar dëbimit me urdhër të gjykatës apo me urdhër ose vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër publik të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

3. Kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet nëse është dënuar më parë për uzurpim të kundërligjshëm të pronës së paluajтshme ose nëse është dëbuar prej pronës së tillë të paluajтshme me vendim të gjykatës apo me urdhër apo vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

3. Kushtet ligjore që kërkohen të përmbushen për ekzistimin e kësaj vepre penale

Nga paragrafi 1 i këtij neni 320 rezulton se kjo vepër penale mund të kryhet me çdo veprim që ka për qëllim uzurpimin e paligjshëm të pronës së huaj – kur pushtimi i një prone të tillë, (futja në posedim e pronës së paluajтshme), nuk është bërë me pëlqimin e pronarit legjitim apo kur nuk është i mbështetur mbi ndonjë veprim ligjor juridik.

Veprimi i kryerjes qëndron në uzurpimin e pronës së huaj të paluajтshme. Me uzurpim duhet kuptuar pushtimi i pronës së huaj të paluajтshme, që mund të shfaqet me veprime të ndryshme, (hyrja në objekte të destinuar për banim, mbi të cilat ende askush nuk ka fituar ndonjë nga të drejtat e banimit: të drejtën e shfrytëzimit, të drejtën banesore a të drejtën pronësore; hyrja në objekte të hapura, thurja, punimi i pronës së huaj, mbledhja e frutave nga

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

punimi i këtillë i tokës, ngritja e objekteve- ndërtimi në pronat e tilla etj).

Objekt mbrojtës i kësaj veprе penale është prona e huaj e paluajtshme , çoftë me status të pronës private, shtetërore apo prona e kulteve fetare, ndërsa kultura mund të jetë e ndryshme, shtëpi –banesë banimi, të zbrazura që akoma askush nuk banon objekt- lokal afarist, objekte ndihmëse , garazh të hapura, tokë ndërtimore, bujqësore, pyll , kullosë , tokë sterile , rrugë etj.

Edhe kjo vepër penale ka për objekt mbrojtjeje, përpos të tjerash, edhe banesat ende të pabanuara dhe objektet e tjera të hapura, ngase, nëse bëhet fjalë për hyrje në banesën mbi të cilën dikush gëzon ndonjërin nga të drejtat sipas Ligjit për Marrëdhëniet banesore, (të drejtën e shfrytëzimit, të drejtën e banimit a të drejtën e pronësisë), dhe për hyrje në objekte të mbyllura, atëherë bëhet fjalë për veprën penale të cenimit të paprekshmërisë së banesave të parashikuara nga neni 197 i KPK.

Kryerës i kësaj veprе penale mund të jetë çdo person.

Për përgjegjësinë e kryesit është e nevojshme dashja e tij, që përfshin në vete vetëdijen e tij se po e pushton pronën e huaj, pa leje të pronarit legjitim, dhe kjo nënkupton se elementet e kësaj veprе penale janë konsumuar vetëm kur pushtimi i pronës është bërë pa pëlqimin e pronarit ose të afërmeve të tij; me këtë rast, nuk është e domosdoshme që pëlqimi të jetë vetëm formal, i shkruar, por mund të jetë edhe gojor.

Paragrafi 2 ka dy nën paragrafë dhe atë 2.1 i cili e bënë cilësuese këtë vepër penale, për shkak të statusit të posaçëm që kanë pronat e pushtuara, siç janë: pjesët e pyllit të mbrojtur, parkut të mbrojtur a një pylli tjetër me destinim të posaçëm ose toka ndërtimore. Ndërsa nën paragrafi 2.2 veprën penale e bënë të cilësuar kur kryesi nuk kishte respektuar vendimet e gjykatës apo të organeve –institucioneve që më parë kishin dhënë urdhër për dëbimin nga prona e cila ka qen objekt uzurpimi.

Paragrafi 3 sipas të cilit kjo vepër penale merr primes cilësuese (rënduese) nëse është kryer nga kryesi i cili edhe më parë ka qenë i dënuar për uzurpim të kundërligjshëm të pronës së paluajtshme ose nëse është dëbuar prej pronës së tillë me vendim të gjykatës apo me urdhër ose vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër të themeluar në bazë të ligjit në Republikën e Kosovës, d.m.th kur bëhet fjalë për recidivist special ose për kryesin i cili nuk respekton vendimet e gjykatës apo institucioneve të autorizuara

Për këtë vepër të cilësuar penale është parashikuar dënim me burgim prej tre muaj deri në tri vjet për dallim nga paragrafi 1 ku parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

3.1.Raste praktike të uzurpimit të paligjshëm të pronës në të kaluarën

“Kur i akuzuari përkundër masës së përkohshme të vendosur nga ana e gjykatës, është futur në pronën e të dëmtarëve dhe ka filluar të kultivoj në të , ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale, pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme të parashikuar nga neni 260 të KPK.¹”

“I akuzuari i cili në ngastrën nr. 1750, Komuna Kadastrale Gjilan, e cila evidentohet si tokë

¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ap.nr.11/2007, datë 23.01.2007.

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

ndërtimore, ka ndërtuar mur me material të fortë ndërtimor, ka konsumuar elementet e veprës penale marrja në posedim e tokës në pronësi shoqërore në mënyrë të paligjshme të parashikuar nga neni 259 A të rregullores 2004/19². Këtu bëhet fjalë për veprën penale të pushtimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme nga neni 259 par. 2 e më pastaj neni 320 i KPK-ës, ndërsa tani sipas KPRK-ës neni 332.³

4. Sanksionet penale që mund të shqiptohen kryesve të kësaj vepre penale si dhe dënimet plotësuese

Sa i përket sanksioneve penale që mund t'i shqiptohen kryesve të kësaj vepre penale ligjvënësi ka paraparë në nenin 320 par. 1 dënim alternativ me gjobë ose me burg deri në 2 vite.

Ne paragrafin dy të këtij neni ligjvënësi ka parapa që nëse vepra penale kryhet në rrethanat e cituara si në nën par. 2.1 dhe 2.2 (nëse prona e paluajtshme e uzurpuar është pjesë e pyllit të mbrojtur, parkut të mbrojtur, me destinim të posaçëm, tokë ndërtimore ose rrugë apo nëse kryesi është në dijeni se prona e tillë i është nënshtruar urdhrit të gjykatës ose me urdhër apo vendim të ndonjë organi publik kompetent) atëherë në këto rrethana është paraparë dënim vetëm me burg prej 3 muaj deri në tre vite.

Në paragrafin tre të këtij neni ligjvënësi ka paraparë dënim me burg prej një viti deri në tre vjet ndaj kryesit i cili është dënuar më parë për uzurpim të kundërligjshëm të pronës me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim apo urdhër të ndonjë organi publik të paraparë të Republikës së Kosovës.

5. Praktika gjyqësore lidhur me politikën ndëshkimore të gjykatave në Republikën e Kosovës:

1.Gjykata Themelore në Pejë, dega Istog, i ka shqiptuar vërejtje gjyqësore të akuzuarit për uzurpim të paligjshëm të pronës së paluajtshme, S. B. Dt. 05.10.2020.

2. Gjykata Themelore në Mitrovicë, e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 350 euro gjobë të akuzuarin për uzurpim të paligjshëm të pronës së paluajtshme, D. E.. Po ashtu, gjykata e ka urdhëruar të pandehurin që brenda 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit të lirojë banesën e uzurpuar në Mitrovicë Dt. 28.09.2019.

3.Gjykata Themelore ne Prishtinë, Dega ne Drenas në lëndën P.nr.237/17 e ka shpallur fajtor të akuzuarin E.G për shkak të veprës penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-ës dhe e ka dënuar me burg të kushtëzuar prej tre muajve brenda periudhës verifikuese prej 1 viti. Në këtë rast gjykata nuk kishte urdhëruar të akuzuarin që t'i liroj pronën të dëmtuarit.

4. Gjykata Themelore në Ferizaj – DP sipas nr. P.nr.523/18 me dt. 18.12.2020 kishte nxjerr

² Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ap.nr.72/2009, datë 12.05.2009.

³ Komentari i KPRK-ës – Botimi I, Prof. Dr. Ismet Salihu etj, Mars 2014, fq 929-931

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

aktgjykim dënues për te akuzuarin për shkak të veprës penale Uzурpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. të KPRK-ës dhe e kishte dënuar me dënim të kushtëzuar prej 4 muaj burg dhe të njëjtin e kishte obliguar që pronën e uzurpuar t'ja kthej të dëmtuarve. Ky aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit sipas nr. PA1.129/20 me dt. 08.04.2021 me ç'rast ishte refuzuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit. Mirëpo lidhur me këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së avokatit mbrojtës të akuzuarit me Aktgjykimin nr. PML.nr.198/21 të dt. 16.06.2021 ka miratuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të sipërcituar dhe të akuzuarin e ka liruar nga akuza. Sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme në rastin konkret nuk ishin përmbushur dy elementet e dispozitës së nenit 320 par. 1 të KPRK-ës pasi që nuk ishte kontestuese se i akuzuari kishte hyrë në posedim të asaj prone por kontestuese ishte mënyra e hyrjes dhe posedimit pasi që i akuzuari kishte hy në posedim të kësaj banese në mënyrë të ligjshme pemës kontratës për qiranë e lidhur midis palëve kontraktuese e legalizuar në Gjykatë në të cilin ishin të theksuara edhe obligimet e palëve kontraktuese. Sipas konstatimit të kësaj gjykatë arsyeja e paraqitjes së rastit në fjalë nga e dëmtuara ishte mos përmbushja e kontratës respektivisht mos pagesa e qirasë. Gjykata Supreme kishte konstatuar se gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë drejtë kishin vetëtuar gjendjen faktike mirëpo gabimisht kishin nxjerr konkludim për provat e administruara pasi që në mënyrë të gabuar kanë interpretuar faktin se mos pagesa e qirasë respektivisht mos përmbushja e kontratës së qirasë përbën bazë për veprë penale pasi që sipas kësaj gjykata uzurpimi i paligjshëm i pronës është tipik për rastet kur bëhet në mënyrë të kundërligjshme dhe pa pasur as një bazë juridike dhe pasi që në rastin konkret mungon ligjshmëria e cila në mënyrë automatike e përjashton uzurpimin dhe se faktet kontestuese midis palëve përkitazi me realizmin e kontratës mund të përbëjnë bazë për kontestet civilo-juridike por në asnjë rrethanë përgjegjësi penale.

6.Të gjeturat e përgjithshme lidhur me Uzурpimin e paligjshëm dhe rikthimin e pronave

- Nga disa forma të siguruara të aktakuzave nëpër prokurori të ndryshme në Kosovës lidhur me veprën penale të Uzурpimit të paligjshëm të pronës në asnjërën prej tyre nuk është gjetur propozim i prokurorit i cituar në propozim të aktakuzës me tp cilin ka kërkuar nga gjykata që të lëshoj urdhër për lirimin e pronës për lirimin e pronës së uzurpuar.
- Nga an tjetër në disa aktgjykime të gjykatave kam gjetur që Gjykata në dispozitiv të aktgjykimit ka urdhëruar të akuzuarin që ta liroj pronën e uzurpuar siç është rasti i një aktgjykimi në Ferizaj i nxjerr në vitin 2016. Përveç këtij rasti ka edhe raste tjera ku të akuzuarit përveç se janë shpallur fajtor për veprën penale të uzurpimit të paligjshëm të pronës janë urdhëruar për lirim prone e në disa raste edhe pa propozim të palëve por sipas detyrës zyrtare.
- Nga aktakuzat e siguruara dhe analizuara është gjetur se kjo veprë penale e Uzурpimit të paligjshëm të pronës është kryer në vazhdimësi duke u cituar se: Kryesi e ka zurpuar dhe mban të uzurpuar mirëpo tek cilësimi juridik i veprës penale në aktakuzë sikurse edhe në aktgjykimin e gjykatës nuk është cekur edhe neni 77 për veprat penale në

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

vazhdimësi i KPRK-ës.

- Sa i përket politikës ndëshkimore që Gjykatat kanë zbatuar me rastin e shpalljes së aktgjykimeve dënuese për veprën penale të uzurpimit të paligjshëm të pronës është gjetur se në rastet e cituara janë shqiptuar dënime me gjobë dhe me kusht sikurse edhe vërejtja gjyqësore. Në asnjërin rast nuk është gjetur se është shqiptuar dënimi me burg efektiv edhe pse këto janë vetëm disa raste dhe kjo nuk nënkupton se gjykata në asnjë rast nuk kanë shqiptuar dënime me burg efektiv ndaj kryesve të kësaj vepre penale.

7. Ri/Kthimi i pronave të uzurpuara pronareve

Neni 464 i KPPK –ës - Kthimi i sendit

Kur kërkesa pasurore – juridike ka të bëjë me kthimin e sendit dhe gjykata konstaton se sendi i takon të dëmtuarit dhe se gjendet tek i pandehuri ose tek njëri nga pjesëmarrësit në veprën penale apo te personi të cilit ia kanë dhënë për ta ruajtur , me aktgjykim urdhëron që sendi t'i dorëzohet të dëmtuarit.

Kthimi i sendit paraqet një rën prej tri formave të kërkesës pasurore juridike dhe për të mund të vendoset vetëm në bazë të propozimit të personit të autorizuar . Kur i dëmtuari kërkon kthimin e sendit , gjykata nuk mund të vendosë për kompensim dëmi në vend të kthimit të sendit.

Sendi , i cili do duhej të jetë objekt kthimi , mund të gjendet :

- tek i pandehuri ose tek ndonjëri nga pjesëmarrësit në veprën penale (bashkekzekutori , shtytësi , ndihmësi , udhëheqësi i grupi kriminal) ; ose

- tek personi të cilit ata ia kanë dhënë për ta ruajtur . Dispozita e paragrafit 1 , duke iu referuar personit të cilit sendi i është dhënë për ta ruajtur , futë në procedurë persona të cilët nuk janë palë as pjesëmarrës të procedurës . Kodi nuk e rregullon më tutje pozitën procedurale të këtyre personave . Duke pasur parasysh faktin se personi i tretë me aktgjykim mund të ngarkohet për ta kthyer sendin , megjithëse kundër tij nuk është paraqitur kërkesë pasurore juridike dhe as që ka qenë palë në procedurë me mundësi kyçe në shqyrtim, dispozita e këtillë për sa i përket pikëpamjes kushtetuese juridike dhe doktrinare është diskutabile, Vendimet që merren sipas kësaj dispozite, të cilat kanë të bëjnë ma marrjen e sendit nga personat e tretë, nuk kanë kurrfarë gjase për t'u pranuar nga shtetet tjera . Urdhri për kthim të sendit nga personat e tretë apo nga bashkekzekutori ose bashkëpunuesi të cilët nuk janë përfshi në një procedurë me të pandehurit ose janë gjykuar në procedurë të pavarur ose procedura kundër tyre fare nuk ka filluar , nënkupton marrje të vendimit për të drejtën e personit i cili nuk merr pjesë në procedurë dhe i cili nuk mund të ankohet kundër vendimit. Mirëpo ndaj personit të tretë mund të caktohet masa e përkohshme sigurimi të cilat vlejné për procedurë penale (neni 469) .

Për kthim të sendit personit të dëmtuarit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte :

Së pari , duhet të ekzistojë propozimi i të dëmtuarit për kthim të sendit .

Së dyti , sendi duhet t'i takojë të dëmtuarit , çka do të thotë se sendi ka qenë në pronësi te dëmtuarit ose në detencion të tij . Fakti i pronësisë nuk vërtetohet me vendim as si çështje paraprake (prejudikuese) . Mjafton konstatimi se i dëmtuari ka qeverisë me sendin në momentin e kryerjes së veprës penale.

Së treti , Sendi gjendet tek i pandehuri ose tek ndonjëri nga pjesëmarrësit në kryerjen e veprës penale (me kusht që ndaj tyre të jetë zhvilluar procedurë e përbashkët) ose tek personi të cilit ata ia kanë dhënë për ta ruajtur . Ndonëse Kodi nuk e thotë shprehimisht, logjikisht mund të konkludohet se për ta kthyer sendin , nevojitet që ai sipas llojit dhe destinimit të tij të jetë në atë formë në të cilën ishte kur ka qenë në detencion të të dëmtuarit. Në të kundërtën mund të

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

kërkohet kompensimi i dëmit.

Vendimi për kthim të sendit merret me aktgjykim me të cilin i pandehuri shpallet fajtor. Kur merret aktgjykim lirues ose aktgjykim refuzues i dëmtuari për realizim të kthimit të sendit udhëzohet në kontest civil . Me atë rast hiqet masa për sigurim të përkohshëm të kërkesës. Kërkesën pasurore juridike e cila ka të bëjë me kthimin e sendit duhet dalluar nga dënimi plotësues :

Sendet merren kur janë pronë e kryerësit , apo pavarësisht pronë e kujt janë nëse :

- prokurori i shtetit përcakton në aktakuzë ato sende , pasuri , prova apo para të cilat i nënshtrohen konfiskimit të përhershëm ;

- nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet , pasuria , provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale ; dhe

- kur ligji lejon konfiskimin e tyre (neni 115 , paragrafi 2). Kthimin e sendit si formë të kërkesës pasurore juridike gjithsesi duhet dalluar nga sendet të cilat kanë bënë me pasurinë e cila sipas nenit 282 i nënshtrohet automatikisht konfiskimit . Kur kemi të bëjmë me aktvendim mbi pushimin e procedurës ose me aktgjykim lirues ose refuzues marrja e sendit çdoherë bëhet me aktvendim të posaçëm.

Në qoftë se me propozim për realizim të kërkesës pasurore juridike nuk është kërkuar kthimi i sendit , marrja e sendit mund të bëhet, përveç kur shqiptohet dënimi plotësues - Marrja e sendit , edhe në bazë të masës Marrja e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

Sa i përket kthimit të sendit si dënim plotësues që ka qenë i parapare me nenin 69 të KPRK-ës paraprak tani me kjo është hjek me Kodin e ri aktual penal.

8. Trajtimi i Uzurpimit të paligjshëm me Ligjin mbi procedurën Kontestimore

Kjo çështje është e rregulluar tek Kreu XXVII respektivisht tek procedura e kontestit për shkak të pengim posedimit duke filluar nga neni 478 në të cilën është paraparë që kjo procedurë është e ngutshme dhe se Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfundohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërjegjeshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfundohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrahet kërkesa për shpërbllimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.

Afatin për përmbushjen e detyrimeve që u janë caktuar palëve gjykata e cakton varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret. Afati për paraqitjen e ankesës është shtatë (7) ditor. Për shkaqe të rëndësishme gjykata mund të vendosë që ankesa mos ta pengojë përmbarimin e aktvendimit. Kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk është i lejuar.

Paditësi e humbe të drejtën që në procedurën përmbaruese të përmbushë detyrimin e aktvendimit me të cilin i padituri urdhërohet që ta përmbushë detyrimin e caktuar, po që se nuk e ka iniciuar procedurën përmbaruese brenda afatit prej 30 ditësh pas skadimit të afatit paritiv. Përsëritja e procedurës së përfunduar me vendim të formës së prerë në kontestet për shkak të pengimit të posedimit lejohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara në nenin 232 pika a) dhe b) të këtij ligji, dhe vetëm brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën është bërë i

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

formës së prerë aktvendimi përfundimtar.

Si me rastin e marrjes së posedimit ashtu edhe me rastin e trazimit themi se fjala është për pengim posedimi.

8.1 Specifikat e procedurës për pengim posedimi

Rregullat e procedurë në kontestet për pengim posedimi janë paraparë në pjesën e III-të të Ligjit të Procedurës Kontestimore ku parashihen rregullat për procedura të posaçme , dhe atë nga neni 478 përfundimisht me nenin 483 . Nëse në këtë pjesë të ligjit nuk ekzistojnë dispozita të veçanta, në këto konteste zbatohen dispozitat tjera të LPK.

Paraqitja e padisë për pengim posedimi është me afat të kufizuar, ashtu që kjo padi mund të paraqitet brenda 30 ditësh nga dita kur paditësi ka kuptuar për pengimin e shkaktuar dhe kryesin (afati subjektiv), përkatësisht brenda një viti nga dita e pengim posedimit (afati objektiv). Padia e paraqitur pas afateve të mësipërme duhet hedhë poshtë si e pasafatshme (neni 77 i LBMJP).

Në kontestet për pengim posedimi gjykata shqyrton gjendjen e fundit faktike, me qëllim të mbrojtjes së saj si dhe aktin e pengim posedimit të ndërmarr nga i padituri, përkatësisht nëse veprimi apo mosveprimi (përmbajtja) i të paditurit përfaqëson aktin e pengim posedimit. Gjykata nuk shqyrton të drejtën në posedim, bazën juridike të posedimit, ndërgjeshmërinë apo jo ndërgjeshmërinë e posedimi si dhe kërkesat eventuale për dëmshpërblim (neni 480 i LPK dhe 78 i LBMJP). Nëse i padituri bën kundërshtim se paditësi ia ka marr posedimin me forcë, me mashtrim apo fshehtazi, gjykata përjashtimisht do të shqyrton lidhur me këtë kundërshtim nëse nuk kanë kaluar 30 ditë nga dita kur ai e ka kthye sendin në posedim (neni 78).

Procedura në kontestet për pengim posedimi është e natyrës urgjente, ka qëllim që sa më shpejtë të rivendoset gjendja ekzistuese para shkaktimit të pengim posedimi, gjë që edhe është parashikuar afati subjektiv për paraqitjen e padisë, 30 ditë, përkatësisht objektiv prej një viti. Afatet për përmbushjen e detyrimit, varësisht nga rasti, janë më të shkurta se zakonisht. Afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditë (neni 481.2 i LPK). Propozimi për ekzekutim me të cilin do të kërkohej ekzekutim i aktvendimit nga kontesti për pengim posedimi, me të cilin i është urdhërua të paditurit të ndërmerr veprimin e caktuar duhet të paraqitet brenda 30 ditësh pas kalimit të caktuar për kryerjen e atij veprimi.

Vetëm në kontestet për pengim posedimi forma e vendimit të gjykatës është aktvendimi (neni 142.3 i LPK), në të gjitha kontestet tjera vendoset me aktgjykim.

Kundër aktvendimeve të marra në kontestet për pengim posedimi nuk është i lejuar revizioni (neni 481.4 i LPK). Në këto konteste lejohet përsëritja e procedurës vetë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 323 pika a. dhe b. të këtij ligji, brenda afatit prej 30 ditësh dita e plotfuqishmërisë (neni 483 i LPK).

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

9. Dallimi midis procedurës civile dhe penale të Uzurpimit të paligjshëm të Pronës

- Qëndron në faktin se në procedurë penale kjo vepër penale ndiqet ex-officio (sipas detyrës zyrtare) e jo me propozim të palës së dëmtuar dhe në momentin kur organet e ndjekjes kuptojnë se dikujt i është uzurpuar prona dhe nuk varet nëse i dëmtuari donë me ndjek apo jo ndërsa në procedurë civile rasti fillohet vetëm me kërkesë (padi) nga i dëmtuari dhe në çdo kohë ai mund ta tërhjek atë.
- Në procedurë civile padi për pengim posedimi mund të ushtroj edhe jo pronari sepse gjykata nuk lëshohet në pronësinë e sendit por vetëm në pushtetin e fundit faktik.
- Afati për ta filluar rastin në procedurë civile me padi për pengim posedimi është vetëm 30 ditë (nga dita kur ka ndodh rasti) ndërsa në procedurë penale vlen afati i përgjithshëm për parashkrim relativ dhe absolut për veprën penale të UPP.

10. Trajtimi i uzurpimit të paligjshëm sipas ligjit nr.05/L - 010 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës

Neni 19 i këtij ligji ka rregulluar çështjen e dëbimit nga prona e uzurpuar , procedurën e cila duhet të ndiqet nga organet kompetente.

Sipas paragrafit 6 të këtij neni: “ Nëse prona **ri uzurpohet** brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve pas kohës së përmbarimit të urdhëresës për dëbim, pas njoftimit nga parashtruesi i kërkesës për ri uzurpimin e kundërligjshëm të pronës Agjencia do ta ri përmbaroj atë edhe një herë përmes ri dëbimit të uzurpuesit nga prona bazuar në urdhëresën e re të lëshuar, duke i respektuar procedurat e paragrafit 3-5 të këtij neni. Për ri dëbim, Agjencia do ta informon paraqitësin e kërkesës për ditën e ri dëbimit dhe do ta fton të jetë i pranishëm gjatë ri dëbimit. Nëse parashtruesi i kërkesës apo i autorizuari i tij/saj dështon të merr pjesë në ri dëbim, Agjencia do ta përmbaron dëbimin dhe do të lëshon vërtetim të ri posedimit”.

Ndërsa nën par 7 ka parapa që për çdo ri uzurpim pasues të pronës se njëjtë, do të zbatohen rregullat e procedurave të përgjithshme të përmbarimit bazuar në te njëjtin vendim/aktgjykim dhe urdhër dëbimi si dokumente përmbaruese.

11. Udhëzimi administrativ (QRK) nr. 01/2020 për përcaktimin e procedurave për shkatërrimin e strukturave të paligjshme⁴

Ky udhëzim administrativ buron nga ligji i sipërcituar për agjencinë kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës i cili udhëzim zbatohet “për pronat në të cilat janë ndërtuar struktura të paligjshme e për të cilat prona ekziston vendim i plotfuqishëm i Komisionit për kërkesa pronësore apo aktgjykim i panelit të ankesave pranë gjykatës supreme”

⁴ Strukturë e paligjshme nënkupton “çfarëdo lloj ndërtimi të paligjshëm në pronën e paluajtshme private që është ndërtuar pa pëlqimin e pronarit” UA 01/2020 fq 3

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Sipas nenit 4 të këtij udhëzimi shkatërrimi i strukturave të paligjshme aplikohet kur: është ndërtuar çfarëdo objekti apo strukture në pronën e paluajtshme private pa pëlqimin e pronarit pronësia e të cilit është njohur me vendim të plotfuqishëm të Komisionit apo aktgjykim të Gjykatës Supreme.

Ky udhëzim ndër të tjera ka rregulluar në tërësi procedurën e paraqitjes dhe shqyrtimit të kërkesës për shkatërrim të strukturave të paligjshme, veprimet që merren para lëshimit të urdhrimit për shkatërrim, procedurën e lëshimit, ekzekutimit, pezullimit të urdhrimit për dëbim dhe shkatërrim, çështjen e rrezikimit të strukturës së ligjshme, lëshimin e vërtetimit për ri-posedim, obligimet e operatorit ekonomik dhe qasjes në pronë.

Ky udhëzim administrativ i nxjerr nga Qeveria e Kosovës ka hyr në fuqi në muajin prill 2020.

12. AKTVENDIM PER PAPRANUESHMERI – Gjykata Kushtetuese e Kosovës ne rastin nr. K1180/19

Objekti i çështjes

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesve të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës], nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave], dhe nenin 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (ne tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] si dhe nenin 1 të Protokollit 1 [Mbrotjtja e Pronës] të Konventës Evropiane për të Drejta e njeriut.

Përmbledhja e fakteve

Bazuar në shkresat e lendes dhe kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë filluar dy procese gjyqësore të ndara dhe se ato i kanë specifikat e tyre. Procedura e pare gjyqësore kishte të bënte me njohjen e të drejtave të banimit mbi pronën në fjalë si dhe rikthimin në posedim të pronës, ndërsa procedura e dyte gjyqësore kishte të bënte me procedurën penale të ngritur nga Prokurori i Shtetit sipas kallëzimit penal të njërit prej parashtruesve të kërkesës kundër M.Gj, për veprën penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve si dhe uzurpimi i paligjshëm i pasurisë së paluajtshme të dikujt tjetër. Procedura për njohjen e se drejtës së banimit mbi pronën në fjalë dhe kthimin në posedim të pronës. Parashtruesit e kërkesës deri në vitin 1999, kanë jetuar në Prizren, në një banesë që gjendej në rrugën "Karadjordjeva" 66/6. Për shkak të ngjarjeve që ndodhën në vitin 1999, parashtruesit e kërkesës u larguan nga banesa e tyre. Banesën, në ndërkohë, e uzurpoi personi M.Gj.

Parashtruesit e kërkesës e dorëzuan një kërkesë pranë Drejtorisë për çështje Banësore Pronësore (ne tekstin e mëtejshëm: DC;PB) ku kërkonin njohjen e se drejtës së banimit mbi pronën në fjalë, si dhe kthimin në posedim të pronës. DC;PB e regjistroi kërkesën e parashtruesve të kërkesës me shenjen DS200S6S.

Gjithashtu, edhe personi M.Gj. paraqiti kërkesë në DC;PB ku pretendonte atij i takonte e drejta mbi pronën në fjalë. DC;PB e regjistroi atë kërkesë me shenjen DS007444. Me 20 gusht 2005,

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Komisioni për Kërkesa pronësore Banësore (ne tekstin e mëtejshëm: KKP) nxori vendimin HPCC/D/210/20S/AC, me të cilin vendosi që personit M.Gj. t'i kthehet e drejta mbi pronën në fjalë, kështu që personi M.Gj. arriti të gjitha të drejtat e një pale të kategorisë A. Me të njëjtin vendim, parashtruesit e kërkesës fituan të drejtën për kompensim si pale e kategorisë C.

Parashtruesit e kërkesës dorëzuan pranë KKP-se një kërkesë për shqyrtimin e vendimit të shkallës së parë HPCC/D/210/20S /AC.

Me 17 janar 2007, KKP lëshoi një vendim të ri HPCC/Rec/88/2007, me të cilin e pranoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të shkallës së parë HPCC/D/210/20S/AC. Në vendimin e ri, KKP vendosi t'u njëjto parashtruesve të kërkesës të drejtën e banimit të pronës në fjalë, ndërsa e refuzoi kërkesën e personit M.Gj. duke theksuar, "që personi M.Gj. nuk ishte diskriminuar në kuptim të mënyrës se si ai i humbi të drejtat e tij të pronës në vitin 1992, sepse urdhri gjyqësor për dëbimin e palës daton që nga viti 1987, dhe kjo është periudha para vendosjes së masave diskriminuese të përkohshme".

Me 24 gusht 2008, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë pranë DC;PB -se, ku kërkonin që prona e tyre që është subjekt i kërkesës të vendoset nën menaxhimin e DC;PB-se. DC;PB e miratoi kërkesën dhe banesa në fjalë ishte nën kontrollin e tyre deri në vitin 2009, kur parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesa për dëbim, përkatësisht, për lirimin e pronës në fjalë nga uzurpuesi.

18. DC;PB-ja e ekzekutoi dëbimin nga prona që është subjekt i kërkesës dhe sipas procedurës, banesa u mbyll dhe u vulos me vulën e DC;PB-se, ndërsa çelësat e pronës në fjalë iu dorëzuan parashtruesit të kërkesës .

Në kërkesë, parashtruesit e kërkesës deklarojnë se, pas vetëm disa ditësh nga dëbimi i ekzekutuar nga DPB-ja, personi në fjalë serish e uzurpoi pronën në fjalë.

Procedura penale kundër personit M.Gj. për shkak të veprës penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve si dhe uzurpimi i paligjshëm i pasurisë së paluajtshme të dikujt tjetër Gjykata e shihet të nevojshme të theksojë se si pale në procedurën penale para Gjykatës Themelore gjendet vetëm bashkëshortja e Milos Seekieit, përkatësisht Ljubica Seekie, e cila e paraqiti kallëzimin penal në Prokurorinë Themelore kundër M.Gj i cili përsëri e uzurpoi pasurinë e paluajtshme në fjalë.

Me 8 qershor 2012, bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës paraqiti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prizren kundër M.Gj. për veprën penale të uzurpimit të paligjshëm të pasurisë së paluajtshme , sipas nenit 332.1 të Kodit Penal të Kosovës" (ne tekstin e mëtejshëm: KPK).

Me 21 nëntor 2017, Prokuroria Publike Themelore ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore në Prizren kundër personit M.Gj., për shkak të dyshimit të bazuar se ai e ka kryer veprën penale të uzurpimit të paligjshëm të pasurisë së paluajtshme, sipas nenit 332.1 të KPK-se.

Me 28 mars 2019, Gjykata Themelore solli Aktgjykimin K nr. 2169-17, me të cilën e refuzoi aktakuzën e Prokurorisë Themelore kundër personit M. Gj, duke deklaruar: "se gjatë dëgjimit kryesor Prokurori u tërhoq nga ndjekja penale e personit M.Gj. , me arsyetimin: "në bazë të shkresave të lëndës ai ka gjetur se shfrytëzuesi i banesës ka qenë Milos Scekie, dhe anëtarët e familjes së tij, përkatësisht gruaja e tij Ljubica, djali Nemanja, djali i dytë Dmtar dhe vajza Jelena, si dhe anëtarë të familjes e kanë përdorur të njëjtën banesë me qiramarrësin Milos Scekie, se banesa në fjalë nuk e ka të zgjidhur çështjen pronësore, gjë e cila konfirmohet edhe

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

nga përgjigja e Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren, e datës 18 tetor 2018, në të cilën konstatohet se kjo banesë nuk është e regjistruar në emër të asnjë pronari".

Bazuar në shkresat e lëndës, vlerësoj se eventualisht i dëmtuari duhet të jetë vetëm Milos Scekić dhe jo ndonjë anëtar tjetër i familjes, sepse, siç; e cekta, anëtarët e familjes së tij do të mund të kishin status eventualisht vetëm nëse i dëmtuari Milos Scekić, do të vdiste dhe jo derisa është gjallë. Vepra penale për të cilën dyshohet i akuzuari mund të ekzistojë vetëm kur prona e përcaktuar me ligj, përkatësisht kur ekziston pronari i pasurisë, sipas nenit 332, paragrafi 1 i KPK-se, gjithashtu edhe për shkak të faktit se çështja e pronësisë së banesës nuk është akoma e përcaktuar në mënyrë të ligjshme, Prokurori Shtetëror TERHIQET nga ndjekja penale e të akuzuarës.

Familjaret e palës së dëmtuar, si dhe vete i dëmtuari, Milos Scekić, për demin eventual mund të paraqesin padi në procedurën kontestimore në gjykatë sepse në këtë çështje penale nuk ka asnjë element të veprës penale.

Pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrijë ankese kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Apelit brenda 15/pesëmbëdhjetë/ ditëve nga data e marrjes së aktgjykimit".

Me 7 gusht 2019, përfaqësuesi ligjor i parashtruesve të kërkesës paraqiti iniciativën për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Prokurorit të Shtetit "që në Gjykatën Supreme të paraqet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore K. nr. 2169-17".

Me 7 shtator 2019, Zyra e Prokurorit të Shtetit iu përgjigj përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës, duke deklaruar "se nuk ka asnjë bazë ligjore për parashtrimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës:

Parashtruesit e kërkesës deklaruan që në fillim "se efekti juridik i vendimeve të DBP-se është i njohur, se ato janë detyruese dhe të zbatueshme dhe se ato nuk mund të jenë subjekt i rishikimit nga ndonjë autoritet tjetër gjyqësor ose administrativ në Kosovë. Mirëpo përkundër që vendimi i vitit 2007 është i plotfuqishëm, ata ende nuk mund të hyjnë në posedim të banesës, përkundër faktit se ata filluan procedurë penale kundër uzurpuesit të banesës".

Në të vërtetë, parashtruesit e kërkesës shkeljet e pretenduara të neneve 24, 31, 32, 46, 54, 109 të Kushtetutës, si dhe nenit 8 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-se i ndërlidhin ekskluzivisht me veprimin e Prokurorit të Shtetit si dhe Gjyqtarit të kësaj çështje në Gjykatën Themelore të Prizrenit.

Me konkretisht, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se ata janë të "diskriminuar nga veprimi i Prokurorit të Shtetit dhe Gjyqtarit të ~çështjes në kuptim të favorizimit të njëres nga palët në procedurën penale, për shkak se në praktiken e Gjykatave Kosovare kur bëhet fjale për kryerjen e një veprë penale nga neni 332.1 i KPK-se, uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme, ekziston një numër i madh i aktgjykimeve ku prokurori shtetëror e përfaqësoi aktakuzën kundër të akuzuarit për veprë penale, ndërsa gjykatat sollën aktgjykime dënuese në favor të palëve të dëmtuara".

Parashtruesit e kërkesës me tej deklarojnë se, pas paraqitjes së kallëzimit penal, Prokuroria Themelore ngriti aktakuzë, por që pas disa seancave dëgjimore, Prokurori vendosi në mënyrë arbitrare që të tërhiqet nga ndjekja penale e mëtutjeshme, sepse konsideronte se nuk kishte elemente të veprës penale, duke përmendur si arsye kryesore se vetëm Milos Scekić mund të paraqitet si pale, duke shkelur kështu nenin 31 të Kushtetutës.

Në këtë drejtim parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se ata tani nuk kanë në dispozicion mjete

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

te tjera juridike përmes te cilave ata do te mund t'i ushtrojnë te drejtat e tyre siç janë përcaktuar ne vendimin e KKBP-se.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se neni 54 i Kushtetutës parasheh qe te gjithë kane te drejte ne mbrojtje gjyqësore, por nga kjo qe u tha me sipër shihet se heqja dore arbitrare e prokurorit nga aktakuza u mohoi palëve te dëmtuara te drejtën e mbrojtjes gjyqësore, duke shkelur kështu drejtpërdrejt nenin 46 te Kushtetutës, si dhe nenin 1 te Protokollit 1 te KEDNJ-se, pasi qe atyre u behet i pamundshëm gëzimi në qetësi i pronës se tyre.

Parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës me një kërkesë qe "te vërtetoj se ka ardhur deri tek shkelja e dispozitave kushtetuese, te shfuqizoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore KK. nr. 269/17, dhe te urdhëroj Prokurorinë dhe Gjykatën Themelore qe te rishqyrtojnë procedurat e shkalles se pare dhe ta kthejnë rastin ne rigjykim". drejtat e Njeriut (ne tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Provueshmëria e kërkesës

Gjykata se pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur te gjitha kriteret e provueshmërisë, te parapara me Kushtetute dhe te specifikuara me tej me Ligj dhe me Rregullore te punës.

Ne këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, te nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] te Kushtetutës, te cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës ne mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (..) 7. Individët janë te autorizuar te ngrënë shkeljet nga autoritetet publike te te drejtave dhe lirive te tyre individuale, te garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi te kenë shteruar te gjitha mjetet juridike te përcaktuara me ligj".

Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 te Ligjit, i cili përcakton:

„[... J 2. Individu mund ta ngrite kërkesën ne fjale vetëm pasi qe te këtë shteruar te gjitha mjetet juridike te përcaktuara me ligj".

Përveç; kësaj, Gjykata merr parasysh edhe rregullin 39 (1) (b) te Rregullores se punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta konsideroje një kërkesë te pranueshme nëse [... J (b) janë shteruar te gjitha mjetet efektive te përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit te kontestuar".

Duke marre parasysh kronologjinë e veprimeve juridike te ndërmarra te parashtruesve te kërkesës, si dhe afatet kohore brenda te cilëve gjykatat e rregullta vendosen mbi thelbin e pretendimeve te tyre, Gjykata konstaton se parashtruesve te kërkesës ne te vërtetë zhvilluan dy procese gjyqësore te ndara, ne te cilat, edhe pse ne thelb ka qene qëllimi i njëjtë, d.m.th., kthimi i te drejtës se banimit dhe te drejtës ne posedim, mbi pronën ne fjale. Me këtë rast, procedurat gjyqësore ne aspektin procedural dalloheshin, si ne aspektin e afateve kohore brenda te cilave vendosen autoritetet kompetente, ashtu edhe ne përmbajtjen e çështjeve me te cilat merreshin ato.

Pikërisht ky dallim i procedurave ka ndikuar qe Gjykata t'i perceptoje dhe t'i analizoje këto procedura gjyqësore ne mënyre te ndryshme.

Procedura e pare gjyqësore me rastin e kërkesëpadsisë për kthim te se drejtës se banimit dhe posedimit te serishëm te pronës në fjalë

Procedura e pare gjyqësore u iniciua nga parashtruesit e kërkesës ne vitin 2005 para DC;PB-se, dhe ajo kishte te bënte me njohjen e te drejtës se banimit mbi pronën ne fjale, si dhe kthimin

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

ne posedim te pronës. Gjykata konkludon se ajo procedure përfundoi me vendimin e plotfuqishëm te KKPБ-se HPCC/Rec/88/2007.

Me konkretisht, ne vendimin HPCC/Rec/88/2007, KKPБ-ja i njohu parashtruesit te kërkesës te drejtën e banimit dhe, rrjedhimisht, kthimin e posedimit te pronës ne fjale.

Gjykata, duke marre parasysh faktin se procedura e pare gjyqësore ne lidhje me kthimin e se drejtës se banimit dhe posedimit te pronës ne fjale, u zgjidh me një vendim te formës se prere te KKPБ-se, dhe ne favor te parashtruesit te kërkesës, konstaton se nuk do te merret me këtë pjese te procedurës gjyqësore, sepse vendimet e KKPБ-se janë favor te tij, dhe se parashtruesi i kërkesës konkretisht nuk i ngreh shkeljet e lartpërmendura ne lidhje me procedurën e pare gjyqësore e cila ishte zhvilluar pranë KKPБ-se, por vetëm ne lidhje me procedurën e iniciuar sipas kallëzimit penal te Ljubica Sceкic, bashkëshortes se Milos Sceкicit, bartësit te se drejtës se banimit mbi pronën ne fjale.

Procedura e dyte gjyqësore lidhur me kallëzimin penal për shkak te uzурpimit te pronës ne fjale Sa i përket procedurës se dyte gjyqësore, Gjykata vëren se ajo ishte nisur nga bashkëshortja e Milos Sceкic (i cili paraqitet para kësaj gjykate si një nga parashtruesit e kërkesës), me 8 qershor 2012, kur ajo parashtroi kallëzim penal ne Prokurorinë Themelore kundër personit M.Gj., për shkak te uzурpimit te pronës ne fjale.

Gjykata vëren se është pikërisht ky veprim procedural i bashkëshortes se parashtruesit te kërkesës qe do te ndikojte ne rrjedhën e mëtutjeshme te procedurës sipas kallëzimit penal, si para Prokurorisë Themelore ashtu edhe përpara Gjykatës Themelore.

Me konkretisht, Gjykata vëren se Prokuroria Themelore se pari e pranoi kallëzimin penal te parashtruar nga bashkëshortja e parashtruesit te kërkesës dhe, prandaj, ngriti aktakuze ne Gjykatën Themelore ne Prizren kundër personit M.Gj .. , me arsyetimin se ai kishte kryer veprën penale te "uzурpimit te paligjshëm te pronës se paluajtshme nga neni 332.1 i KPK-se. Megjithatë, Gjykata konstaton se Prokuroria Themelore ndërkohë hoqi dore nga ndjekja penale e personit M.Gj, per disa arsye:

i)sepse si pronar i se drejtës se banimit mbi pronën ne fjale ne vendimin e KKPБ--se përmendet bashkëshorti Milos Sceкic dhe jo bashkëshortja Ljubica Sceкic, e cila para Prokurorisë Themelore paraqitet si paditëse. Ne te vërtete, ne baze te kallëzimit penal dhe vendimeve te KKPБ-se, prokuroria konkludoi se ne baze te vendimit te formës se prere te KKPБ-se, Milos Sceкicit iu pranua e drejta e banimit mbi pronën ne fjale, por jo edhe paditëses, ne rastin konkret Ljubica Sceкic.

ii) sepse banesa ne fjale nuk e ka te zgjidhur çështjen e pronësisë, gjë qe konstatohet ne baze te inspektimit te dokumentacionit te Shërbimit për Gjeodezi dhe Kadastër ne Prizren, te 18 tetorit 2018, konkretisht, se, edhe nëse ka një vendim te formës se prere nga KKPБ-ja ne lidhje me banesën ne fjale, titullari, te cilit KKPБ-ja i ka kthyer te drejtën e banimit mbi pronën ne fjale, konkretisht Milos Sceкic, nuk ka ndërmarrë te gjithë hapat e nevojshëm procedural për t'i regjistruar ato si te tilla ne emrin e tij ne shërbimin kompetent, qe prokuroria e përmbylli ne baze te dokumenteve përkatëse te lëshuara me kërkesën e tij nga shërbimi kompetent komunal.

iii) dhe si arsyeja e trete e heqjes dore nga aktakuza penale, prokuroria përmendi faktin se vepra penale sipas nenit 332 paragrafi 1 i KPK-se, për te cilën është dyshuar e paditura mund te ekzistojte vetëm kur prona përcaktohet me ligj dhe kur ekziston një pronar i pronës ne fjale i cili inicion kallëzim penal, qe sipas arsyetimit me mësipërm nuk kemi te bëjmë ne këtë rast.

Ne këtë drejtim Gjykata vëren se, duke marre parasysh arsyetimin e prokurorisë themelore,

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

gjykata themelore nxori aktgjykimin me te cilin e refuzoi padinë kundër personit M.Gj.

Prandaj, Gjykata konstaton se, si pretendim parësor, për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre, parashtruesit e kërkesës deklarojnë se prokuroria themelore, me heqjen dore arbitrare nga ndjekja penale, u mohoi atyre të drejtën e mjetit juridik gjate procedurës përpara gjykatave të rregullta, me çka atyre i shkelen edhe të gjitha të drejtat dhe liritë e tjera të cilat ata i kane deklaruar në kërkesë.

Ne baze të kësaj, mund të shtrohet pyetja nëse parashtruesit e kërkesës, përkundër faktit që Prokuroria Themelore hoqi dore nga ndjekja penale, kishin në dispozicion të tyre mjetet juridike për të vazhduar procedurën gjyqësore në lidhje me pronën në fjale.

Gjykata duke trajtuar këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, ka analizuar me kujdes vendimin e prokurorisë themelore për heqjen dore nga ndjekja penale, me ç' rast ka konstatuar se përkundër faktit se Prokuroria e kontestoi legjitimitetin e paditëses, në këtë rast, bashkëshortes së Milos Scekcic-it, bartësit të së drejtës së banimit, nuk e ndalon asgjë që kallëzimin penal në lidhje me uzurpimin e pronës në fjale ta iniciojë përsëri, me çka do largohej pengesa procedurale që do t'i mundësonte Prokurorisë Themelore e gjithashtu edhe gjykatave të rregullta procedimin penal të së paditurës.

Gjykata gjithashtu nuk mund të mos vërejë që, Gjykata Themelore përkundër heqjes dore të Prokurorisë Themelore nga ndjekja penale e personit M.Gj., u dha parashtruesve të kërkesës udhëzime se si ata mund të realizojnë të drejtat e tyre duke i udhëzuar ata për procedure kontestimore. Në lidhje me këtë, Gjykata Themelore deklaroi: "Anëtarët e familjes së palës së dëmtuar, si dhe vete pala e dëmtuar Milos Scekcic, për demin eventual mund t'i drejtohen gjykatës kontestimore me një padi sepse nuk ka asnjë element të një veprë penale në këtë ~është penale".

Për më tepër, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu injoruan udhëzimet për mjetin juridik të Gjykatës Themelore, i cili kishte të bënte me mundësinë që ata të parashtronin ankese në Gjykatën e Apelit brenda afatit 15 ditësh nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore. Prandaj, parashtruesit e kërkesës hoqën dore nga ai mjet juridik me qëllim të paraqitjes së "Nismës për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Prokurorit të Shtetit".

Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konstaton se është e qarte se parashtruesit e kërkesës nuk i morën parasysh arsyetimet ligjore dhe udhëzimet ligjore të cilat, Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore i kane dhënë në vendimet e tyre, dhe me vete këtë, nuk eliminuan mangësitë procedurale të cilat do t'u mundësonin atyre që përsëri të paraqesin kallëzim penal pranë Prokurorisë Themelore, ose përndryshe, ata nuk filluan procedurën kontestimore para një gjykate kompetente, ku do të diskutoheshin meritat e "kërkesës" se tyre në lidhje me pronën në fjale, për të cilën gjë kishin të drejte sipas udhëzimit mbi mjetin juridik nga Gjykata Themelore. Prandaj, Gjykata vjen deri të konkludimi i parë, se kane ekzistuar mendësitë ligjore, të cilat i mundësonin parashtruesve të kërkesës që të vazhdojnë me procedurën gjyqësore, gjë që çon në konkluzionin e dytë se parashtruesit e kërkesës nuk kishin shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Kushtetute, Ligj dhe Rregullore të punës, dhe me vete këtë nuk kane arritur tek vendimi përfundimtar në lidhje me të drejtat dhe obligimet e tyre. Gjykata rikujton se vendimi përfundimtar është një përgjigje për mjetin e fundit juridik, i cili është efektiv dhe adekuat për të shqyrtuar vendimin e instancës me të ulet, si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik (shih vendimin në rastin KI134/19, Dobrica Pucar, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 30).

Ne baze të asaj që u tha më sipër, Gjykata konstaton se, në të vërtetë, parashtruesit e kërkesës

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

e kane sjelle vetveten ne një shtate procedurale qe kërkesëpadia e tyre te mos mund te shqyrtohet ne baze te meritave te saj nga gjykatat e rregullta, për arsye se ata nuk kane vepruar ne pajtim me kërkesat procedurale dhe obligimet ligjore te cilat e bëjnë te mundur nisjen e procedurave para gjykatave kompetente.

Gjykata shton, se nuk ka asgjë qe pengon parashtruesit e kërkesës qe te eliminojnë pengesat procedurale, si ato sipas kallëzimit penal parashtruar Prokurorisë Themelore, ashtu dhe ato për fillimin e procedurës kontesti more para gjykatës kompetente, me çfarë do te krijoheshin mundësitë procedurale për gjykatat e rregullta qe ne pajtim me nenin 31 ne lidhje me nenin 32 te Kushtetutës te marrin parasysh dhe shqyrtojnë te gjitha pretendimet e tyre, si dhe pretendimet ankimore, dhe kësisoj te vendosin për te drejtën, ne pajtim me nenin 46 te Kushtetutës, e qe çon ne krijimin e një shtate ligjore, e cila hap mundësinë qe parashtruesit e kërkesës ne një moment te caktuar te marrin një vendim përfundimtar ne lidhje me pronën ne fjale, për te cilin, nëse ata nuk janë te kënaqur, gjithashtu mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese brenda afatit te përcaktuar.

Ne baze te gjithë kësaj qe u tha me larte, Gjykata vjen ne përfundim se parashtruesit e kërkesës nuk i kane shteruar te gjitha mjetet juridike te parapara me ligj ne lidhje me pronën ne fjale, (shih, nder te tjera, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI07/ 09, Dëme dhe Besnik Kurbogaj, Aktvendim për papranueshmëri i 19 majit 2010, paragrafët 28-29, KII178/18, Bujar Hoti, Aktvendim për papranueshmëri i 30 janarit 2019, paragrafi 26).

Prandaj, kërkesa e parashtruesve është e papranueshme për shqyrtim ne pajtim me nenin 113.7 te Kushtetutës, nenin 47.2 te Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) te Rregullores se punës.

PER KETO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, ne pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 te Kushtetutës, nenin 47 te Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) te Rregullores se punës, ne seancën e mbajtur me 12 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJE kërkesën te papranueshme;

II. T'UA KUMTOJE këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJE këtë vendim ne Gazetën Zyrtare, ne pajtim me nenin 20.4 te Ligjit;

IV. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

13. Raporti vjetor nr.15 i vitit 2015 i Institucionit të Avokatit të popullit

Ndër të tjera thekson se:

Më 15 qershor 2015 USAID (Programi për të Drejtat Pronësore) kishte organizuar një tryezë lidhur me zbatimin e vendimeve të lëshuara nga Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKKP) e AKPr në të cilën ishte ftuar edhe IAP-i. AKPr kishte paraqitur sfidat me të cilat ballafaqohet në zbatimin e vendimeve të KKKP-së.

AKPr-ja ka paraqitur gjithashtu edhe disa nga sfidat lidhur me përfundimin e plotë të mandatit të AKPr-së e që janë:

- Implementimi i Skemës së Kompensimit (143 raste);
- Implementimi i shkatërrimit të strukturave të paligjshme (28 raste);
- Procesi i dëbimeve në pjesën Veriore të Mitrovicës;
- Ri uzurpimet e pronave***, etj.

AKPr-ja ka sqaruar se shumica e sfidave të përmendura kanë implikime financiare dhe se përmbushja e tyre varet nga mbështetja financiare e Qeverisë dhe donatorëve eventual.

Pika 1.3.3.1 e këtij raporti ka parashtruar rastet e ri uzurpimit të pronave të liruara nga AKPr-ja ku është cituar se:

Në përgjithësi rastet e uzurpimit të pronave në Kosovë janë një dukuri mjaft e shprehur. Në veçanti është e shprehur dukuria e ri uzurpimit të kundërligjshëm të pronave nën administrimin e AKPr-së. Sipas një raporti të Misionit të OSBE-së në Kosovë, 41 ndërmjet viteve 2008 dhe 2013, AKPr ka referuar 326 raste të tilla të ri uzurpimit në prokurori, të cilat kishin të bënin me pronë nën administrimin e saj dhe numri i ri uzurpimeve të paligjshme në të gjithë Kosovën me gjasë është më i lartë kur përfshihen edhe pronat që nuk janë nën administrimin e AKPr-së. Sikur në rastet kur bëhet fjalë për pronat e uzurpuara që janë nën administrimin e AKPr-së ashtu edhe uzurpimeve tjera të paligjshme të pronave në përgjithësi bëhet fjalë për veprë penale, dhe se rastet e uzurpimeve të kundërligjshme procedohen ose do të duhej të procedoheshin në prokurori dhe më tutje në gjykata. Vonesat në trajtimin e rasteve nga autoritetet publike, prokuroritë dhe gjykatat, të cilat zënë vend në shumë raporte të Avokatit të Popullit, ndikojnë drejtpërdrejtë në të drejtën pronësore.

Tutje sipas këtij raporti, Avokati i Popullit gjatë vitit 2015 ka pranuar dy ankesa nga pronarët e rinj të pronave të privatizuara lidhur me uzurpimin e këtyre pronave dhe pamundësimin e lirim të tyre nga AKPv-ja, Policia e Kosovës dhe Gjykata Themelore e Prishtinës. Gjatë hetimit të rastit Avokati i Popullit ka konstatuar se ka hezitim nga organet e rendit për të liruuar pronat e uzurpuara. Po ashtu, Avokati i Popullit ka konstatuar se Gjykata Themelore e Prishtinës, ku ankuesit kishin paraqitur padi për lirim të pronave, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për vendosje lidhur me paditë e pronarëve të ri. Avokati i Popullit mbetet i shqetësuar me mosveprimin e organeve të rendit dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës në lirim të pronave

duke marrë parasysh që uzurpimi i pronës paraqet veprë penale. Sidoqoftë, Avokati i Popullit i kishte fokusuar hetimet në përgjegjësitë e AKPv-së për lirim të këtyre pronave, para se të

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

lëshohet në hezitimin për të zgjidhur këto raste nga organet e rendit dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës. Avokati i Popullit ka mësuar se AKPv-ja në nëntor të vitit 2014 kishte nxjerrë Vendimin nr. 270/2014 dhe Udhëzuesin për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit (Shfrytëzuesit e Paligjshëm) që vlen për pronat që aktualisht janë nën juridiksionin e AKPv-së dhe veprimet që AKPv-ja i ka ndërmarrë për lirim të pronave që janë në shitje, por të cilët nuk vlejné edhe për pronat që janë shitur para nëntorit të vitit 2014. Me gjithë faktin që vendimi i AKPv-së paraqet një iniciativë të mirë për të siguruar se AKPv-ja do të garantojë shitje të pronave të liruara nga të metat juridike, në këtë rast uzurpimit të pronave, kjo nuk zgjidh situatën e pronave të shitura nga AKPv-ja duke mos i liruuar ato nga uzurpatorët dhe shfrytëzuesit e kundërligjshëm. Lidhur me këtë Avokati i Popullit është duke e përpiluar një raport me rekomandime për AKPv-në dhe Policinë e Kosovës.

Sipas pikës 1.4.2. të këtij raporti i cili flet për të drejtat pronësore:

Çështja e mbrojtjes së pronës dhe respektimin e të drejtave të pronësisë, në kontekstin e të drejtave pronësore të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, edhe më tutje mbetet një sfidë e madhe për autoritetet e Republikës së Kosovës. Një punë të madhe në lidhje me këtë çështje e ka bërë Agjencia Kosovare e Pronës (AKPr), e cila deri në fillim të qershorit 2015 ka zgjidhë të gjitha kërkesat e parashtruara në shkallë të parë (42,749), ndërsa ende të pa zgjidhura kanë mbetur më shumë se 500 raste të cilat ndodhen në procedurë sipas ankesës pranë Kolegjit të Apelit të AKPr-së në Gjykatën Supreme të Kosovës. IAP çështjen e punës dhe mandatit të AKPr-së e ka trajtuar në një seksion të veçantë të këtij raporti i cili lidhet me të drejtat e pronësisë në përgjithësi. Këtu duhet theksuar problemin e shumë përhapur dhe trendin negativ të ri-uzurpimit të pronës së paluajtshme, si dhe problemet e qytetarëve që përballen me të. Problemi mund të klasifikohet si një dështim i përgjithshëm si i pushtetit ekzekutiv ashtu edhe atij gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ndonëse ri-uzurpimi i pronës është një vepër penale e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës (neni 332 i KPK-së) dhe për të cilat parashihet një dënim me burgim deri në tre vjet, nuk ka ndonjë rast të organeve gjyqësore se kjo dispozitë është zbatuar në praktikë. Përveç kësaj, pronarët e pronave të ri-uzurpuara janë në pamundësi që të zgjidhin këtë problem, në mënyrë të përhershme, sepse pavarësisht nga paraqitja e kallëzimeve penale dhe raportimin e uzurpimit në PK, të njëjtat procedohen vite me rrallë, ndërsa PK pavarësisht kompetencave të dhëna me Ligjin e Policisë (konkretisht nenin 11.1 i Ligjit për Policinë) refuzon për të intervenuar dhe nga personat e dëmtuar kërkon një urdhër gjyqësor për dënim për të reaguar në raste të tilla, çka për fat të keq është bërë një praktikë e përhapur në përgjithësi në PK. Gjithashtu, PK mundet në raste të tilla të ndërhyjë në bazë të kompetencave të dhëna me Kodin e Procedurës Penale (KPP), sipas të cilit PK-së i lejohet që përkohësisht të arrestojë dhe të ndalojë një person sikurse është personi i cili përsëri në mënyrë të paligjshme e merr apo e uzurpon pronën e huaj, kur kapet në kryerjen e veprës penale, do të thotë në vendin e ngjarjes.

Neni 11.1 Ligji për Policinë nr.04/L-076 ku theksohet se: "Një polic ka autoritetin për të ushtruar kontroll të arsyeshëm mbi personat dhe pronën brenda juridiksionit dhe kompetencave të tij për të nxjerrë dhe zbatuar urdhrat e ligjshme dhe udhëzime për anëtarët e shoqërisë në tërësi për arritjen e objektivave legjitime të policisë", që do të thotë se autoriteti PK ka autoritet të përgjithshëm të hyjë në objekte për të ndaluar kryerjen e një krimi i cili po ndodhë, të tilla si uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga një palë e tretë.

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Neni 162 LPP nr.04/L-012 ku theksohet: „Nëse personi është gjetur në kryerjen e një veprе penale ndiqet sipas detyrës zyrtare ose të ndiqet penalisht, policia ose çdo person tjetër i autorizuar mundet ta arrestoj përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës”.

Raporti i lartë theksuar citon se: Personat e dëmtuar mund të ju drejtohen autoriteteve gjyqësore për të rikonfirmuar dhe vendosur, të drejtat pronësore, të cilat janë të vërtetuara dhe për të ngritur padi për pengimin e posedimit ose dëbimin e personave që janë vendosur në mënyrë të paligjshme, për të cilat presin nga disa vite deri në një vendim përfundimtar dhe të zbatueshëm të gjykatës, ndërsa gjatë kësaj kohe personat që janë vendosur në mënyrë ilegale edhe më tutje disponojnë lirshëm dhe të papenguar me pronën e tjetrit. Fatkeqësisht, këto raste ende përfaqësojnë një nga problemet më të mëdha në lidhje me gëzimin e lirë dhe disponimin e pronës private, e të cilat është e nevojshme të zgjidhen në periudhën e ardhshme. Gjithashtu, duhet theksuar se problemi i uzurpimit të serishëm të pronës së paluajtshme deri para pak kohe ka prekur vetëm pjesëtarë të komuniteteve pakicë, por tani me këtë problem përballen edhe pjesëtarët e komunitetit shumicë, që po bëhet një problem i përgjithshëm me gëzimin e lirë dhe disponimin e pasurisë, e që është në kundërshtim me parimet demokratike dhe të përgjithshme të respektimit të të drejtave të njeriut. Situata në të cilën një pjesë e qytetarëve nuk është në gjendje për të disponuar lirisht pronën e tij krijon mosbesim në institucionet si dhe një klimë që justifikon ekzistencën e pasigurisë juridike.

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

14. Raporti i OSBE-s – Janar 2015: Shqyrtimi rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm në Kosovë

Ky raport shqyrton reagimet e institucioneve të Kosovës në rastet e ri uzurpimeve të paligjshme të pronave nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) dhe paraqet një vlerësim të trajtimit të përgjithshëm të rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm nga sistemi në fuqi.

Ri uzurpimi i paligjshëm ndodh kur një individ ose një grup individësh, të cilët janë dëbuar nga një pronë në bazë të një urdhri të ligjshëm për dëbim, më pas e uzurpojnë sërish atë. Ri uzurpimi i pronës për të cilën është lëshuar një urdhër dëbimi përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës dhe në ato raste mund të shqiptohet dënimi deri në tre vjet burgim. Ri uzurpimi i paligjshëm i pronave është fenomen i pranishëm në tërë Kosovën që ndikon edhe në pronat private edhe në ato nën administrimin e AKP-së.

Rastet e ri uzurpimit të pronave nën administrimin e AKP-së për të cilat AKP ka ngritur kallëzim penal në prokurori janë kryesisht të natyrës ndëretnike, që përfshijnë një pronar serb të pronës dhe një uzurpues shqiptar. Gjykimi efektiv i këtyre rasteve do të kontribuojë jo vetëm në krijimin e sigurisë ligjore por edhe do të ndihmojë në përpjekjet e pajtimit ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

Për të vlerësuar reagimin e institucioneve në rastet e ri uzurpimeve të paligjshme, OSBE ka shqyrtuar të gjitha rastet që përfshijnë prona nën administrimin e AKP-së në periudhën 2008 deri 2013. Kufizimi i mbulimit të hulumtimit vetëm në pronat e administruara nga AKP ka mundësuar identifikim të lehtë të pronave që janë subjekt i ri uzurpimit. Një pengesë e këtij vendimi ishte se janë lënë jashtë ri uzurpimet e paligjshme të pronave në zotërim vetanak dhe nën administrim të pronarëve privatë, të cilat janë raste po aq të rëndësishme. Meqë të gjitha rastet kanë të bëjnë me ri uzurpimin, dëbimi fillestar nga AKP me ndihmën e Policisë së Kosovës (PK) është kryer në të gjitha këto raste. OSBE-ja ka shqyrtuar progresin e çdo rasti nga identifikimi fillestar i ri uzurpimit të paligjshëm deri te përmbarimi i vendimit të plotfuqishëm. Vlerësimi ka gjetur shqetësime serioze në lidhje me zbatimin e dëbimeve nga ana e institucioneve të Kosovës.

Këto raste nuk janë komplekse nga ana juridike: rastet përgjithësisht përfshijnë një të pandehur; sasia e provave është mesatare; shkalla e kompleksitetit të çështjeve juridike të përfshira është e ulët; dhe nuk ka konteste të pazgjidhura pronësore.

Megjithatë, përkundër thjeshtësisë relative të tyre, për shkak të reagimit të ngadaltë të prokurorisë dhe gjyqësorit, këto raste mesatarisht zgjasin dy vite e tre muaj për t'i proceduar nga koha kur lënda dorëzohet nga AKP në zyrën e prokurorisë deri tek aktgjykimi i plotfuqishëm i një gjykate themelore. Përveç kësaj, mund të vërehen një numër mangësish tjera në reagimin e autoriteteve në rastet e ri uzurpimit të paligjshëm të cilat parandalojnë zgjidhjen efektive të këtyre rasteve. Këto përfshijnë faktin që: AKP nuk informon PK-në për ri uzurpimin e paligjshëm, duke i lënë uzurpuesit e paligjshëm në pronë gjatë tërë procedurës së lëndës; prokuroria nuk ka nënvizuar natyrën ndëretnike të rasteve dhe nuk ka kërkuar ndëshkime të rrepta; dhe gjykatat nuk kanë urdhëruar ri dëbim; gjykatat gjithashtu kanë prirje të nxjerrin dënime të shkurtra, të dënimit me kusht, gjë që nuk është masë për parandalimin e kryesve të tjerë.

Procedurat për trajtimin e rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm dhe faktet themelore të ri uzurpimit të paligjshëm janë të njëjta pavarësisht nëse AKP administron pronën ose prona është

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

në administrim privat. Kështu, shqyrtimi i rasteve që përfshijnë rastet e administruara nga AKP mund të zbardhë mënyrën se si me gjasë trajtohen nga sistemi edhe rastet që përfshijnë prona që nuk administrohen nga AKP. Gjykatat nuk kanë nxjerrë urdhra për rikthim të pronës për kompensimin e pronarëve të pronës.

Koordinimi më i mirë nga ana e institucioneve përkatëse ekzekutive dhe një fokus më i madh në seriozitetin e këtyre rasteve nga ana e gjykatave me siguri do të çonte në zbatim dukshëm më të mirë të rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm dhe ulje të këtyre rasteve në të ardhmen.

Raporti përfundon me rekomandime të cilat, mes tjerash, nënvizojnë nevojën që veprat të kualifikohen në mënyrë adekuate nga prokuroria, dhe që gjykatat ta kryejnë procesin gjyqësor në kohë, të nxjerrin vendime bazuar në rrethanat individuale të rasteve, dhe që gjithmonë në dispozitiv të urdhërohet lirin e pronës së uzurpuar nga ana e uzurpuesve të paligjshëm, në vend që të shqiptohen dënime me kusht, si rregull i përgjithshëm.

Zbatimi i urdhrave për dëbim dhe administrim të pronës në tërë Kosovën vazhdon të jetë sfidues. Raporti i Progresit për Kosovën 2013, i publikuar nga Komisioni Evropian, konstatoi se janë rreth 820 dëbime të pakryera, nga të cilat rreth 350 janë në veriun e Kosovës 2. Shumë kërkesa të pazgjidhura për kompensim të pronës qëndrojnë në gjykata dhe shpeshherë urdhrat për dëbim në rastet e zgjidhura nuk respektohen, ku personat e dëbuar kthehen dhe ri uzurpojnë pronat. Ndërmjet viteve 2008 dhe 2013, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ka referuar 326 raste të tilla të ri uzurpimit në prokurori, të cilat kishin të bënin me prona nën administrimin e saj 3, dhe numri i ri uzurpimeve të paligjshme në të gjithë Kosovën me gjasë është më i lartë kur përfshihen edhe pronat që nuk janë nën administrimin e AKP-së.⁴ Zgjidhja efektive e rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm është me rëndësi të madhe për të drejtat dhe integritetin e komunitetit serb të Kosovës. Mbi 95 për qind të rasteve të AKP-së që janë referuar në zyrat e prokurorisë përfshinin prona të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës që janë ri uzurpuar paligjshëm nga pjesëtarë të komunitetit shqiptar në Kosovë. Ekziston një histori e dhunës së lidhur me pronat në Kosovë, e cila vazhdon edhe në ditët e sotme. Për shembull, kanë qenë rreth 120 vepra pronësore të raportuara në Policinë e Kosovës (PK) gjatë tërë Kosovës në vitin 2013. Prandaj, zgjidhja efektive e këtyre rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm është po ashtu me rëndësi kritike për sigurinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Rastet e ri uzurpimit të paligjshëm të pronave nuk janë komplekse nga aspekti juridik, meqë ato përgjithësisht përfshijnë një të pandehur, sasia e dëshmive është jo mbi mesataren, shkalla e kompleksitetit të çështjeve juridike të përfshira është e ulët, si dhe nuk ka konteste të pazgjidhura pronësore. Duke i pasur parasysh këto arsye, zyrat e prokurorisë duhet t'i ngrisin aktakuzat edhe më herët se që kanë vepruar gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport⁵.

Nga 326 raste, 65 raste janë nga rajoni i Mitrovicës. Rastet që AKP i ka trajtuar deri më tani kanë të bëjnë vetëm me pronat në jug të lumit Ibër. Rastet e ri uzurpimit të paligjshëm që përfshijnë prona që nuk janë të administruara nga AKP nuk mund të identifikohet lehtësisht. AKP-ja nuk mban të dhëna mbi rastet e ri uzurpimit të paligjshëm që kanë të bëjnë me pronat që ajo nuk i administron.

Qëllimi i raportit është të përcaktojë nëse institucionet e Kosovës janë duke ofruar zgjidhje

⁵ Shih Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2013, të Komisionit Evropian në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

efektive për rastet e ri uzurpimeve të paligjshme. Në përputhje me mandatin e OSBE-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore të komuniteteve të Kosovës, si dhe sigurinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë, ky raport ofron një analizë të reagimit të institucioneve të Kosovës në këto raste duke shfrytëzuar një nëngrup të pronave të ri uzurpuara paligjshëm të administruara nga AKP.

Kur AKP dëbon shfrytëzuesin fillestar të paligjshëm të pronës, pronari i pronës ka të drejtë të zgjedhë në mes administrimit të pronës së tij nga AKP ose ri posedimit. Nëse zgjidhet kjo e fundit, AKP më nuk e monitoron pronën, për shembull për të siguruar se ajo nuk është ri uzurpuar dhe nuk ndërmer veprime në rast se ajo ri uzurpohet. Në këtë rast, pronari duhet ta ngrisë çështjen e ri uzurpimit tek institucionet përkatëse vendore.

Gjetjet e raportit janë bazuar në një analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave të marra nga AKP, si dhe të aktakuzave, propozim-akuzave dhe aktgjykimeve të mbledhura nga shtatë zyra rajonale të prokurorive themelore dhe shtatë gjykatave themelore në Kosovë. Për realizimin e këtij vlerësimi, monitoruesit e sistemit të drejtësisë të OSBE-së kanë përcjellë trajtimet e institucioneve të të gjitha rasteve të AKP-së. Në kohën e raportimit, në gjykim janë futur 137 raste. Nga këto raste, gjykatat kanë qenë në gjendje të prodhojnë shkresa të lëndës, përfshirë aktakuza, aktgjykime dhe dënime për 117 raste. Këto 117 raste janë nëngrupi i rasteve që përbëjnë bazën e këtij raporti. OSBE-ja ka kryer një shqyrtim të thellë të aktakuzave dhe aktgjykimeve të shqiptuara në këto raste për ta vlerësuar dhe krahasuar kualifikimin e veprave penale me dënimet e shqiptuara. Krahas shqyrtimit të dokumenteve nga zyra, në periudhën mes tetorit 2013 dhe tetorit 2014, OSBE-ja ka monitoruar 93 seanca dëgjimore në 50 raste të hapura që kishin të bënin me ri uzurpimet e paligjshme të pronës, duke vëzhguar praktikën e procesit gjyqësor dhe prokurorial që ka të bëjë me ri uzurpimet e paligjshme.

Kufizimi i mbulimit të hulumtimit vetëm në pronat e administruara nga AKP ka mundësuar një identifikim të lehtë të pronave që ishin subjekt i ri uzurpimit. Një pengesë e këtij vendimi ishte se me këtë janë lënë jashtë rastet e ri uzurpimeve të paligjshme të pronave në zotërim vetanak dhe ato nën administrim të pronarëve privatë. Megjithatë, procedurat për trajtimin e rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm nga prokuroria dhe gjykatat dhe faktet themelore të ri uzurpimit të paligjshëm janë të njëjta pavarësisht nëse AKP-ja administron me pronën ose nëse prona është në administrim privat. Kështu, shqyrtimi i rasteve që përfshijnë rastet e administruara nga AKP mund të zbardhë mënyrën se si me gjasë trajtohen nga sistemi edhe rastet që përfshijnë prona që nuk administrohen nga AKP. Raporti është i ndarë në pesë pjesë.

Pjesa e dytë paraqet një pasqyrë të kornizës ndërkombëtare dhe asaj të Kosovës.

Pjesa e tretë përvijon çështjet e identifikuar në rastet në trajtimin efektiv të rasteve të ri uzurpimit. Pjesa e katërt paraqet konkluzionet e raportet dhe, në fund,

Pjesa e pestë jep rekomandime për akterët përkatës. Në rastet e mbetura, as nëpunësit e gjykatës as gjyqtarët nuk ishin në gjendje t'i gjejnë shkresat e lëndës. Megjithatë, në ato raste, fakti që rasti është përfunduar dhe data e aktgjykimit apo hedhjes së rastit është shënuar në regjistër⁶.

Me rëndësi të veçantë është *neni 1 i Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Protokollin 1) i cili parashikon se çdo njeri ka të drejtë në gëzim paqësor të pronës dhe se askush nuk duhet të privohet në mënyrë të paligjshme nga pronës e*

⁶ Shih. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE DHE E KOSOVËS 2.1 Korniza ligjore ndërkombëtare Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) dhe protokollet e saj, si edhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

tij. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka përcaktuar se çdo ndërhyrje në pronë duhet të jetë: 1) e ligjshme; 2) në interes publik, me fjalë të tjera, në zbatim të një qëllimi legjitim; dhe 3) proporcionale . Sipas GJEDNJ, shkelja e nenit 1 të Protokollit 1 ndodh kur një aplikanti i është “mohuar qasja, kontrolli, përdorimi dhe gëzimi i pronës, si dhe kompensimi për ndërhyrje në të drejtat e tij pronësore”. Asnjë nga rastet e vlerësuara për qëllime të këtij raporti nuk kanë përmbushur kërkesat e GJEDNJ-së për ndërhyrje të lejueshme në të drejtën e gëzimit të qetë të pronës.

Sipas kornizës ligjore të Kosovës Ri uzurpimi i pronës së paluajtshme përbën vepër penale të sanksionuar me nenin 332 të Kodit Penal të Kosovës.

Neni 332, paragrafi 3, thekson se “Kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet nëse është dënuar më parë për uzurpim të kundërligjshëm të pronës së paluajtshme ose nëse është dënuar prej pronës së tillë të paluajtshme me vendim të gjykatës apo me urdhër apo vendim të ndonjë organi apo institucioni tjetër të themeluar në bazë të ligjit të zbatueshëm[...]. “Ky paragraf është i aplikueshëm për rastet e ri uzurpimit të një prone.

Dy vepra të tjera penale të cilat janë përdorur shpeshherë në lidhje me rastet e ri uzurpimit të pronës janë, “Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave”, dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet, dhe “Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve”, që dënohet me burgim deri në tri vite.

Vepra e parë penale përdoret shpeshherë për shkak se, pasi që të lirohet prona e uzurpuar nga AKP-ja, asaj gjithmonë i vendoset vula për të parandaluar uzurpuesit nga hyrja në të dhe largimi i vulës përbën vepër penale në vete, vepra e dytë penale është vepër e përgjithshme që parandalon kryerësit që të hyjnë në pronën private të dikujt. Asnjëra nga këto dy vepra të lartcekura penale nuk kërkon përcaktimin e “qëllimit” të kryerësit për të uzurpuar pronën për një periudhë më të gjatë kohore. Shih nenin 17(2) të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 10 dhjetor 1948, që thekson se “askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga prona e tij”. Shih gjithashtu nenin 1 të Protokollit të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ). Shih neni 22 të Kushtetutës së Kosovës,

Rasti: *Albergas dhe Arlauskas kundër Lituaniës*, paragrafi 58, GJEDNJ, Aktgjykimi i 27 majit 2014. Orphanides kundër Turqisë, paragrafi 35, GJEDNJ, Aktgjykimi i 20 janarit 2009, i plotfuqishëm më 6 korrik 2009. 11 Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-082 1 janar 2013.

SHQETËSIMET E IDENTIFIKUARA NË TRAJTIMIN EFEKTIV TË RASTEVE TË RIUZURPIMIT TË PALIGJSHËM

Sipas raportit të lartë theksuar të OSBE-s: Mes viteve 2008 dhe 2013, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) referoi në prokurori gjithsej 326 raste të ri uzurpimit të paligjshëm nën administrimin e saj. OSBE-ja e pranoi këtë listë të rasteve nga AKP-ja dhe i përcjelli rastet përgjatë fazave të ndryshme të procedurës penale pranë zyrave të prokurorisë dhe gjykatave. Më shumë se 95 % e tyre përfshinin prona në pronësi të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës që ishin ri uzurpuar paligjshëm nga pjesëtarët e komunitetit shqiptar të Kosovës. Në të gjitha rastet, AKP-ja, në përputhje me mandatin e saj, zbatoi dëbimin fillestar me ndihmën e PK. Dëbimet ishin të pasuksesshme në kuptim të asaj se më pas pronat u uzurpuan sërish. AKP-ja, në cilësinë e saj si administrator i pronës në fjalë, më pas iu drejtua sistemit të drejtësisë penale për të trajtuar ri uzurpimin. Deri në tetor të vitit 2014, aktgjykimet e

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

plotfuqishme u nxorën në 42 për qind (137 raste) të këtyre rasteve. Mesatarisht, dy vjet e tre muaj kohë u nevojiten për rastet për të cilat u nxor një aktgjykim i formës së prerë, nga dorëzimi i rastit nga PK në zyrën e prokurorit ndonëse kjo ndryshon shumë nga njëri rajon në tjetrin.

Nga të gjeturat vërehet se në dhjetor të vitit 2013 e ishte shënuar përparim në përsheptimin e zgjidhjes së këtyre rasteve me një numër jashtëzakonisht të madh të aktgjykimeve të nxjerra për rastet e ri uzurpimit të paligjshëm. Megjithatë ky përparim dëshmoi të jetë vetëm i përkohshëm.

OSBE-ja ka gjetur mangësi të mëdha në përpunimin dhe zbatimin e rasteve të ri uzurpimit të paligjshëm që rrezikojnë të drejtën e gëzimit paqësor të pronës sipas nenit 1 të Protokollit 1. Gjetjet e veçanta janë paraqitur në hollësi në vijim:

Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) - Dorëzimi i kallëzimeve penale në Policinë e Kosovës Mandati i AKP-së është zgjidhja e kërkesave pronësore për pronë të paluajshme private dhe kërkesat për të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajshme private atëherë kur pronari nuk është në gjendje t'i ushtrojë këto të drejta, dhe gjatë kryerjes së detyrave të veta ajo mund t'i vendos pronat nën administrimin e saj.

Monitorimi i OSBE-së tregon se në rastet e ri uzurpimit të paligjshëm, AKP-ja dorëzon drejtpërdrejtë kallëzim penal për ri uzurpim të paligjshëm vetëm në zyrat përkatëse të prokurorisë dhe jo edhe në PK.

Në asnjë rast AKP-ja nuk ka dorëzuar kallëzim penal në PK apo nuk ka kërkuar zbatimin e serishëm të njoftimit fillestar për dëbim. Kjo ndryshon nga procesi që përdoret për të zbatuar urdhrin fillestar për dëbim, gjatë së cilit proces AKP-ja punon ngushtë me PK për të siguruar se dëbimi po kryhet.⁷ Kjo është vërtetuar gjatë disa intervistave që monitoruesit e OSBE-së i kanë zhvilluar me përfaqësuesit e AKP në periudhën mes shtatorit të vitit 2013 dhe shkurtit të vitit 2014.

Mënyra më efektive përmes së cilës një i dyshuar mund të largohet menjëherë nga pronë është nëse AKP paraqet kallëzim për dëbim të serishëm në PK, e cila më pas mund të vazhdojë me ekzekutimin e urdhrin fillestar për dëbim, ta largojë dhe/ose përkohësisht ta arrestojë dhe paraburgosë kryerësin. Për shkak se kjo nuk bëhet, personi i cili uzurpon paligjshëm pronën mund të qëndrojë në pronë duke vazhduar të kryejë veprën penale të ri uzurpimit të paligjshëm deri në zgjidhjen e rastit e që mund të zgjasë disa vite në disa gjykata.

Dorëzimi i kallëzimit pranë PK nuk parandalon AKP që ta referojë rastin edhe në prokurori. Duke qenë se ri uzurpimi i paligjshëm është vepër penale, procedurat duhet gjithashtu të nisen me qëllim të ndjekjes penale të ri uzurpuesit të paligjshëm dhe kompensimit të palës së dëmtuar. Njoftimi i të dyja institucioneve për ri uzurpim të paligjshëm mbase do të siguronte një trajtim fillestar më efektiv të rastit.

Përcjellja e rastit, mënyra se si ruhen të dhënat/regjistrat për ri uzurpimin e paligjshëm nga AKP-ja dhe se si përcillen nga institucionet e zbatimit të ligjit gjithashtu paraqet shqetësim. Lista që AKP ka ndarë me OSBE përmban 366 raste të referuara. Sidoqoftë, pas një hetimi

⁷ Shih nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10. Shih nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 që përkufizon përgjegjësitë e AKP-së. Shih po ashtu nenin 16.5 të së njëjtës rregullore që përcakton se “çdo person i cili pa arsye ligjore hyn në pronën e plumbosur duke e thyer atë i nënshtrohet largimit nga pronë nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit” (më pas e zëvendësuar me anë të Ligjit nr. 03/L-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajshme private duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, 13 qershor 2008). Shih po ashtu nenin 69 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 04/L-12 (KPPK), 1 janar 2013, që autorizon policinë për të hetuar veprat penale.

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

shtesë nga OSBE-ja, del se 40 regjistra në listën e AKP-së ishin llogaritur dy herë. Prandaj, disa raste që në të vërtetë ishin zgjidhur, konsideroheshin si të pazgjidhura nga AKP-ja. Përveç kësaj, rreth 29 raste në listën e AKP-së të rasteve të referuara në prokurori nuk mund të gjendeshin as në prokurori, as në gjykata.

Neni 8.2 i Ligjit për policinë i jep PK autorizime të përgjithshme për të ndihmuar autoritetet qendrore dhe lokale të qeverisjes në kryerjen e detyrave të tyre publike, të tilla si dëbimi: *“Me kërkesë të institucioneve të qeverisjes qendrore ose lokale, policia është e autorizuar t’ju ofroj ndihmë në kryerjen e detyrave publike, kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose e personave që kryejnë detyra publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm ndaj veprimeve të tyre.”*

Përveç kësaj, *PK ka autorizim të përgjithshëm për të hyrë në ndërtesa për të ndaluar kryerjen e një veprë penale, të tillë si ri uzurpimi i paligjshëm.* Sipas nenit 11.1 të Ligjit për policinë (*“gjatë kryerjes së detyrave policore, zyrtari policor ka autorizim të ushtrijë kontroll të arsyeshëm mbi njerëzit dhe pronën në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij apo të saj, të jap dhe të zbatoj urdhra dhe instruksione të ligjshme për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi, për t’i arritur objektivat ligjor të policisë”*).

Policia edhe mund ta arrestojë përkohësisht dhe ta ndalojë një person, si një ri uzurpues të paligjshëm, i cili kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale. Sipas nenit 162 të KPK, (*“Kur një person kapet në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose është në ndjekje për veprën e kryer penale, policia ose çdo person tjetër është i autorizuar ta arrestojë atë përkohësisht edhe pa urdhër të gjykatës”*).

Neni 6(2) të KPK përcakton: *“procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer veprë penale.”* Neni 6 (3) përcakton se “prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të dëmtuarit.”

Ngatërrimet rreth numrit të vërtetë të rasteve të ri uzurpimit në lidhje me pronën e administruar nga AKP-ja dhe statusi i këtyre rasteve pengon zbatimin efektiv të këtyre veprimeve. Mbajtja më e mirë e të dhënave dhe një komunikim më proaktiv mes AKP-së dhe zyrave të prokurorisë për statusin e rasteve është i nevojshëm për të qartësuar rëndësinë e çështjes së ri uzurpimit të paligjshëm.

Çështjet lidhur me zyrat e prokurorisë:

Rastet ende të pazgjidhura pranë zyrave të prokurorisë Deri në tetor të vitit 2014, 71 raste janë referuar nga AKP në zyrat e prokurorisë në periudhën viteve 2008 dhe 2013 të cilat ende nuk ishin trajtuar në zyrat e prokurorisë, pra as me ngritjen e aktakuzës, as me akuza të hedhura poshtë nga prokurorët. Trajtimi i rasteve nga zyrat e prokurorisë në Prishtinë dhe Mitrovicë ngre shqetësime të veçanta. Nga 36 raste të paraqitura nga AKP-ja në zyrën e prokurorisë në Prishtinë, 17 raste janë ende të pa trajtuara. Sipas prokurorëve në këtë zyre, në të gjitha 17 rastet identiteti i kryerësit nuk mund të përcaktohej.

Duke marrë parasysh atë se AKP-ja tashmë kishte nxjerrë urdhër për dëbim ndaj uzurpuesve, është e paqartë përse prokurorët nuk mund të përcaktojnë identitetin e kryerësve. Numri i madh i rasteve ku uzurpatori emërtohet si i “panjohur” tregon për dështim në procesin e hetimit. Në

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

rajonin e Mitrovicës gjendja është më e ndërlikuar sesa në rajonet e tjera. AKP-ja konfirmoi se i ka dorëzuar 65 raste në zyrën e prokurorisë mes viteve 2008 dhe 2013. Zyra e prokurorisë deklaroi se ka pranuar 53 raste, por aktakuza është ngritur vetëm në dy prej tyre. Për më tepër, për shkak të mungesës së hapësirave për zyre dhe kushteve të vështira të punës, zyra e prokurorisë në Mitrovicë i ka kërkuar AKP-së që të mos paraqes më raste të tjera deri në njoftim tjetër. Duke pasur parasysh se natyra e këtyre rasteve është kryesisht ndëretnike dhe e lidhur me konfliktin, si dhe që karakteri i tyre është relativisht i thjeshtë, këto raste duket se janë të atij lloji që duhet të trajtohen nga zyra e prokurorisë në Mitrovicë pa marrë parasysh kushtet e punës në të cilat punohet.

Koha e nevojshme për të ngritur aktakuzën në mbarë Kosovën, koha mesatare që nevojitet për ngritjen e aktakuzës që nga momenti kur dorëzohet kallëzimi penal pranë cilësdо zyre të prokurorisë është pesë muaj, ndonëse kjo ndryshon nga një rajon në tjetrin. Rastet e ri uzurpimit të paligjshëm të pronave nuk janë të ndërlikuara nga perspektiva juridike, meqë: ato zakonisht përfshijnë vetëm një të pandehur; shkalla e provave është mesatare; niveli i ndërlikimit të çështjeve juridike është i ulët

Në kohën e botimit të këtij raporti, ishin të panjohura arsyet përse vetëm këto dy aktakuza ishin ngritur.

Për këto arsye, zyrat e prokurorisë duhet të ngrenë aktakuza më shpejtë se që kanë bërë gjatë periudhës së mbuluar në këtë raport. Zyrat e prokurorisë në Gjilan, Pejë dhe Gjakovë, në një afat prej dy muajsh ose më pak, treguan se kjo gjë është e mundshme. Në të vërtetë, siç mund të shihet në grafikun 3, dy nga këto zyra – ajo në Pejë dhe Gjakovë– kanë numër më të madh të këtyre rasteve në krahasim me disa rajone që reagojnë më ngadalshëm, të tilla si Prizreni dhe Prishtina.

Përmbajtja e aktakuzës Mes vitit 2008 dhe fundit të vitit 2012, zyrat e prokurorisë ngritën propozim akuzë në 220 raste, siç kishin të drejtë sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale. Që nga 1 janari 2013, aktakuzat e rregullta u ngritën duke qenë se më nuk ishte e mundshme parashtrimi i propozim akuzës sipas Kodit të ri të Procedurës Penale. Megjithatë aktakuzat e rregullta të ngritura në vitin 2013 ishin kryesisht të formës së propozim akuzës. Për shembull, prokurorët dështuan që të përshkruajnë siç duhet natyrën ndëretnike të rastit dhe në përgjithësi ata e konsideronin AKP e jo pronarin e vërtetë të pronës, si palë të dëmtuar duke qenë se prona është nën administrimin e AKP-së. Pronari i vërtetë i pronës në përgjithësi nuk është cekur në propozim akuzë/aktakuzë dhe gjithashtu nuk është konsideruar si dikush i cili do të duhej ftuar në shqyrtim gjyqësor.

Në 117 rastet e përfunduara që OSBE i ka shqyrtuar në hollësi, prokurorët kanë dështuar të ngritin akuzë të duhura duke i pasur parasysh faktet. Për shembull, në 94 raste është ngritur aktakuzë vetëm për kryerjen e veprës “heqje apo dëmtim i vulave apo shenjave zyrtare”, ndonëse nga faktet e çështjes duket qartë se i pandehuri ka hequr vulën zyrtare në mënyrë që të mund të hyjë sërish në pronë.

Meqë të pandehurit nuk akuzohen edhe për “uzurpim në mënyrë të paligjshme të pronës së paluajtshme,” përveçse për heqje të vulës zyrtare, aktgjykimi nuk përmban udhërin për dëbimin e të pandehurit nga prona. Për më tepër, duke e akuzuar të pandehurin vetëm për një vepër penale në vend se për dy, nuk arrihet që të dëshmohet pesha e rastit dhe të shqiptohet një dënim më i lartë për dy veprat në bashkim.

Përfundim përbëjnë lëndët e paraqitura në Gjykatën Themelore të Gjakovës: nga 32

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

aktgjykime të prera që janë shqyrtuar, në të gjitha rastet me përjashtim të njërit të pandehurit janë akuzuar për kryerjen e të dyja veprave penale.

Vepra e parë “konsumohet” me heqjen e vulës zyrtare, ndërkaq vepra e dyte penale kryhet në vazhdimësi, për aq kohë sa prona e paluajtshme të jetë në posedim të të pandehurit. Sipas KPK, dënimi maksimal për kryerje të veprës penale të heqjes së vulave zyrtare ishte më i lartë se sa ai për veprën penale të uzurpimit të paligjshëm. Tani KPP nuk e parasheh një gjë të tillë.

OSBE ka vërejtur që prokurorët gjithnjë mbanin qëndrim pasiv, duke i lënë gjithçka në dorë gjyqtarit dhe duke mos dhënë asnjë sugjerim për dënimin, por thjesht propozonin vetëm që të pandehurit të dënoheshin “në pajtim me ligjin”. Madje edhe atëherë kur prokurorët kërkonin të shqiptohet ndonjë dënim specifik, në të shumtën e rasteve fjala ishte për dënime që ishin ose dënime minimale ose aty diku afër tyre. Për shembull, në disa raste prokurorët kanë kërkuar vetëm urdhër ndëshkimor (me fjalë të tjera, gjobë). Parë së bashku, faktorët e sipërpërmendur duket sikur sugjerojnë që në shumë raste nuk janë zhvilluar hetime dhe ndjekje penale efektive. Në lidhje me këtë, GJEDNJ ka konstatuar që “nëse pengimi është i natyrës penale, institucionet janë gjithashtu të obliguara që të kryejnë hetim penal dhe, po të jetë nevoja, ndjekje penale efektive”⁸. Vonesat e paarsyeshme: Nga 220 akuza dhe propozim akuza të ngritura nga prokuroritë, gjykatat themelore kanë nxjerrë vendim për 137 raste. Gjykata të caktuara përballen me numër të madh të lëndëve të pazgjidhura. Vonesa të mëdha paraqiten edhe gjatë procedimit të këtyre lëndëve nëpër gjykata. Për të nxjerrë një aktgjykim duhen mesatarisht 22 muaj, megjithëse kohëzgjatja dallon shumë nga njëra gjykatë në tjetrën.

Në disa raste, gjykata themelore nuk ka qenë në gjendje që ta paraqesë dosjen e lëndës, por vetëm fakte që ka përfunduar lëndën dhe që data e nxjerrjes së aktgjykimit apo lirimit nga akuza është regjistruar në shkrimoren e gjykatës.

Disa gjykata që kanë numër relativisht të madh të lëndëve të pazgjidhura (p.sh. Prishtina i zgjidhin lëndët shpejt, derisa të tjerat që kanë numër të vogël të lëndëve të pazgjidhura (p.sh. Gjilani) i zgjidhin ngadalë. Karakteristikat e veçanta të lëndëve të riuzurpimit në mënyrë të paligjshme – natyra e tyre relativisht e thjeshtë, elementi ndëretnik, si dhe ndikimi në të drejtat e komunitetit serb të Kosovës në pronë dhe banim – tregojnë që këto lëndë do të duhej të shqyrtoheshin në mënyrë më të përshpejtuar. Megjithatë, në disa gjykata këto lëndë nuk po trajtohen me urgjencën e duhur. Fakti që Gjykata Themelore e Prishtinës dhe ajo e Gjakovës mund t’i zgjidhin lëndët për mesatarisht afro 10 muaj dëshmon që këto lëndë mund të procedohen relativisht shpejt, pavarësisht ngarkesës relativisht të madhe me lëndë të pazgjidhura, siç është rasti në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Shqiptimi i dënimit - Dënimet e ulëta përbëjnë shqetësim të madh. Nga 117 lëndët e përfunduara me aktgjykim të cilat i ka shqyrtuar në hollësi OSBE,⁹⁷ janë aktgjykime fajësuese mirëpo as edhe për një rast të vetëm nuk janë shqiptuar dënime privuese të lirisë. Përkundrazi, nga 34 gjoba të shqiptuara, më larta e vrojtuar nga OSBE-ja ka qenë një gjobë në shumën prej €600. Janë identifikuar gjithsej 59 dënime me kusht, ndër të cilët më i ashpri ishte dënim me kusht me një vit burgim nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda dy viteve të ardhshme. Një faktor që ka kontribuar në nxjerrjen e vendimeve të këtilla të ulëta është pasiviteti i prokurorëve gjatë shqyrtimit gjyqësor.

⁸ Rasti Blumberga kundër Letonisë, Aktgjykimi i GJEDNJ i 14 tetorit 2008.

Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

Megjithatë, gjykatat e kanë në fund të fundit për detyrë që të garantojnë proces të rregullt gjyqësor dhe të sigurojnë që të merren parasysh faktorët, përfshirë këtu gjithë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ashtu që dënimi që shqiptohet të reflektojë në masë të mjaftueshme peshën e krimit. Gjithashtu, përveç shpalljes fajtor të të pandehurit për uzurpim të paligjshëm të pronës, gjyqtarët duhet që në dispozitivët e aktgjykimeve dënues të saktësojnë gjithmonë që i pandehuri duhet të largohet nga prona, nëse ndodh që ky i fundit vazhdon ta uzurpojë atë. Sidoqoftë, në rastet në fjalë, dëbimi i të pandehurit nga prona është urdhëruar në vetëm shtatë nga rastet në fjalë, të gjitha lëndë të Gjykatës Themelore në Gjakovë, gjë që tregon se uzurpimi i pronave mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të procedurës penale.

Kompensimi - Gjykatat nuk nxjerrin gjithashtu as vendim për kompensimin e pronarit, ndonëse një e drejtë e tillë parashihet me Kodin e Procedurës Penale. Gjykatat nuk kanë caktuar kompensim në asnjërin prej 97 aktgjykimeve fajësuese që i ka shqyrtuar OSBE. Në vend të kësaj, pas shpalljes së dënimit, gjykatat zakonisht e udhëzojnë AKP-në (apo pronarin e pronës, nëse është i pranishëm) që të ngritë padi civile për kompensim të dëmit, e që është praktikë shumë joefikase dhe mbas gjase në dëm të palës së dëmtuar, e cila do të duhet që të bëjë shpenzime shtesë dhe të presë më shumë kohë derisa ta realizojë kërkesën në gjykata civile. Gjykata penale do të duhej që ta udhëzojë palën e dëmtuar mbi të drejtën për të kërkuar dhe realizuar kërkesat pronësore. Gjykata mund ta referojë palën për të iniciuar procedurë të veçantë civile vetëm nëse vlerëson se nuk ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur kërkesën pronësore.

Siç u përmend më parë, në këtë kuptim GJEDNJ ka konstatuar që institucionet kanë detyrimin pozitiv për të siguruar që “të drejtat në pronë të mbrohen në masë të mjaftueshme me ligj, dhe të sigurohen mjete juridike të përshtatshme që do t’i mundësonin viktimës të kërkojë realizimin e tyre, duke përfshirë, po të jetë e përshtatshme, kërkimin e kompensimit për çfarëdolloj humbjesh të shkaktuara”⁹. Mos përfshirja e kërkesës për kompensim shkon kundër frymës së këtyre standardeve ndërkombëtare, sidomos po të merret parasysh që të dëmtuarit në këto raste ka të ngjarë të jenë PZHBV dhe, për rrjedhojë, kanë më pak mundësi të kërkojnë drejtësi në gjykatat e Kosovës.

Ekzekutimi i dënimeve - Në fund, mangësi ka edhe për sa i përket zbatimit të dënimeve. Vetëm 20 nga 34 gjobat e shqiptuara janë paguar, ndonëse shkalla e ekzekutimit të vendimeve dallon në masë të madhe nga njëra gjykatë themelore në tjetrën. Vetëm në një rast në Gjykatën Themelore të Gjilanit është shqiptuar dënim privues nga liria për mos pagesë të gjobës. Për më tepër, duket se mungon një (qoftë në gjykata, qoftë në prokurori), që do ta bënte të mundur të verifikohet nëse kryesi të cilit i shqiptohet dënimi me kusht ka kryer ndonjë vepër tjetër gjatë periudhës sa ka zgjatur dënimi. **PËRFUNDIM**

Vlerësimi i mësipërm shpërfaq mangësi serioze në zbatimin, ndjekjen dhe gjykimin e këtyre veprave, duke vënë kështu në rrezik realizimin e së drejtës për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën të paraparë me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Duke marrë parasysh natyrën e veprës dhe potencialin që ka ajo për të dëmtuar raportet ndëretnike, këtyre rasteve duhet t’ju kushtohet rëndësi nga të gjitha institucionet gjegjëse dhe duhet të merren masa për të siguruar që ri uzurpuesit e paligjshëm të largohen nga pronat dhe të marrin dënimet e duhura brenda një kohe të arsyeshme. Për shembull, për të siguruar zbatim të urdhrit për dëbim të nxjerrë herën e parë,

⁹ Blumberga kundër Letonisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 14 tetorit 2008, paragrafi 67.

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

AKP duhet të paraqesë kallëzim penal në polici në rast të ri uzurpimit të pronës që ka nën administrim.

Megjithatë, vlerësimi ka vënë në dukje që AKP nuk përdorë ndihmën e policisë për të siguruar zbatimin e urdhrin për dëbim. Prokuroritë po dështojnë vazhdimisht që ta vënë në dukje natyrën ndëretnike të këtyre rasteve dhe të kërkojnë dënime që do t'i parandalonin veprimet e tilla në të ardhmen. Gjithashtu, pavarësisht nga elementi ndëretnik dhe natyra e qartë e rasteve të ri uzurpimit në mënyrë të paligjshme, disa prokurori dhe gjykata nuk i shqyrtojnë ato me urgjencën e duhur. Gjoha e shqiptuar prej €200 u zëvendësua me 13 ditë burgim për shkak të mos pagesës. Si rrjedhojë e këtij mos efikasiteti, ri uzurpuesit po munden që të vazhdojnë të qëndrojnë në prona deri në zbatimin e plotë të vendimit për dëbim, e që mesatarisht merr afro dy vjet e tre muaj, dhe dënimet për këto veprime janë jashtëzakonisht të buta. Nga 326 raste të ri uzurpimit të raportuara nga AKP prej 2008 deri në 2013, janë paguar vetëm 20 gjoha dhe vetëm një person ka vuajtur dënim privues lirie për arsye të mos pagesës së gjobës. Nuk është shqiptuar asnjë dënim privues lirie, dhe nuk është nxjerrë asnjë urdher për kompensim të pronarëve.

Me gjithë këto mangësi thelbësore, ka megjithatë edhe ca praktika të mira. Për shembull, në Gjakovë, pavarësisht nga problemet sikurse mos nxjerrja e urdhrave për kthim të pronës dhe mosekzekutimi i dënimeve, rastet procedohen nga prokuroritë dhe zgjidhen nga Gjykata Themelore brenda një viti nga momenti kur AKP paraqet rastin në prokurori. Për më tepër, nga sa ka vërejtur OSBE, prokuroria në Gjakovë është e vetmja që i akuzon kryerësit si për veprën penale të “heqjes apo dëmtimit të vulave zyrtare ose shenjave” ashtu edhe atë të “uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme”, ndërsa Gjykata Themelore e Gjakovës është e vetmja që në aktgjykim urdhëron edhe dëbimin (ndonëse kjo praktikë nuk ka qenë e rregullt).

REKOMANDIME :

Agjencia Kosovare e Pronës:

- Të ngritë me kohë kallëzime penale në Policinë e Kosovës dhe zyra të prokurorëve sa herë që vihet në dijeni të ri uzurpimit të paligjshëm.
- T'i udhëzojë prokurorët që përveç gjositjes dhe/ose dënimeve me privim lirie të kërkojnë edhe kompensim financiar.
- Të sigurojë regjistrimin sistematik të të dhënave rreth ri uzurpimeve dhe përcjelljen e vazhdueshme të ecurisë së rasteve të paraqitura në Policinë e Kosovës dhe prokuroritë.

Për prokurorët publikë :

- T'i procedojnë shpejtë për në gjykata rastet e ri uzurpimit të pronës në mënyrë të paligjshme.
- Të përmirësojnë cilësinë e akuzave të ngritura ashtu që, për shembull, të përmendin natyrën ndëretnike të rastit dhe pronarit.
- Të ngritin akuza për shkelje të dispozitave që rregullojnë heqjen e vulave zyrtare, si edhe ri uzurpimin e pronave.
- Të jenë pro aktivë në kërkimin e dënimeve, ndëshkimeve dhe në raste të caktuara edhe dënimeve me privim lirie për të shërbyer si parandalim në të ardhmen.

Uzarpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

- Të kërkojnë kompensim financiar për pronarin e pronës.
- Të sigurojnë mbajtjen e regjistrave për personat e dënuar me kusht.

Për gjykatat:

- Së paku, rastet e ri uzurpimit t'i shqyrtojnë brenda afateve kohore të parapara me ligj.
- T'i kushtojnë vëmendje natyrës ndëretnike të rastit dhe nevojës për të shqiptuar dënime që do ta ndalonin përsëritjen e kësaj veprë në të ardhmen.
- Të nxjerrin urdhër për kompensim financiar të pronarit, përveç rasteve kur është e qartë se një gjë e tillë është e përealizueshme për shkak të natyrës komplekse të çështjes.
- Në dispozitivin e aktgjyqimeve fajësuese, të përfshijnë gjithmonë një nen që përcakton largimin e gjithë uzurpuesve të paligjshëm nga prona.

Uzурpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave

15. Konkluzione të përgjithshme të trajnimit - Rekomandime

- Vepra penale e Uzурpimit të paligjshëm të pronës është vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe pa marr parasysh faktin se pala e dëmtuara apo ankuesi a ka filluar procedurën administrative apo civile në momentin kur organet e ndjekjes vihen në dijeni se dikujt i është uzурpuar prona në mënyrë të kundërligjshme atëherë duhet ta trajtojnë atë duke marr veprimet sipas ligjit;
- Prokurori me rastin e draftimit dhe dorëzimit të aktakuzës në gjykatë t'i propozoj gjykatës në pjesën e propozimit të aktakuzës që gjykata të nxjerr urdhër për kthimin e pronës së uzурpuar pronarit me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit dënues ndaj të pandehurit;
- Gjykata me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit dënues për të pandehurin krahas shqiptimit të dënimit në dispozitiv të urdhëroj të akuzuarin që të liroj pronën e uzурpuar sepse vetëm në këtë mënyrë të dëmtuarit do ti jepej satisfaksioni i duhur për t'ja siguruar të drejtën në pronë të garantuar edhe me Kushtetutë;
- Me rastin e ri amandamentimit të KPRK-ës të rregullohet mirë çështja e kthimit të pronës së uzурpuar pronarit ku me një dispozitë të veçantë çoftë tek pjesa e dënimeve plotësuese apo një paragraf i ri tek neni 320 të theksohet se :” Gjykata e urdhëron të akuzuarin që t'ja liron pronën e uzурpuar me njëherë të dëmtuarit;
- Sa i përket politikës ndëshkimore që Gjykatat kanë zbatuar deri më tani për të cilin edhe Kosova ka marr kritika si nga akterët vendor ashtu edhe ndërkombëtar për shkak të trajtimit jo të duhur dhe dënime jo adekuate në këto raste të uzурpimeve të kundërligjshme andaj në të ardhëm Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimeve në rastet e uzурpimeve të kundërligjshme t'i zbatojnë udhëzimet që dalin nga udhëzuesi i shqiptimit të dënimeve të nxjerra nga Gjykata Supreme e Kosovës.